**Ofruesi i Shërbimeve të Navigacionit Ajror**
**Pružaoc Usluga u Vazdušnoj Plovidbi**
**Air Navigation Services Provider**



# RAPORTI VJETOR I PUNËS 2024

PËRMBAJTJA


1. MESAZHI I DREJTORIT ....4
2. PROFILI I KOMPANISË ....5
   2.1. THEMELIMI I OFRUESIT TË SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR (KANS) ....5
   2.2. STATUSI I OFRUESIT TË SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR ....6
3. MISIONI DHE VISIONI ....7
4. SHËRBIMET KRYESORE ....8
   4.1. SHËRBIMET E TRAFIKUT AJROR ....8
   4.2. SHËRBIMET E INFORMACIONEVE AERONUATIKE ....8
   4.3. SHËRBIMET METEOROLOGJIKE ....8
   4.4. KOMUNIKIMI/ NAVIGIMI/VËZHGIMI ....8
5. PROJEKTET DHE AKTIVITETET KRYESORE 2024 ....9
   5.1. LIGJI PËR OFRUESIN E SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT ....9
   5.2. NORMALIZIMI I HAPËSIRËS (ULËT) AJRORE ....9
   5.3. IMPLEMENTIMI I SISTEMIT PËR MENAXHIMIN E TRAFIKUT AJROR (ATM) ....10
   5.4. PËRMIRËSIMI (UPGRADE) I RADARIT TË GOLESHIT ....11
   5.5. MARRËVESHJET E NIVELIT TË SHËRBIMIT (SLA) ....12
   5.6. SHFRYTËZIMI I BURIMEVE NATYRORE TË ENERGJISË ....13
   5.7. NGRITJA E KAPACITETEVE NJERËZORE ....14
   5.8. ISO ÇERTIFIKIMI ....15
6. PLANET STRATEGJIKE ....16
7. AUDITET ....17
   7.1. AUDITET E BRENDSHME SIGURISË ....17
   7.2. AUDITET E JASHTME TË SIGURISË ....17
   7.3. AUDITET E NJAB ....18
8. STRUKTURA ORGANIZATIVE ....19
9. RRJEDHA E TRAFIKUT AJROR ....20
   9.1. OPERIMET KOMERCIALE ....20
   9.2. OPERIMET USHTARAKE ....22
   9.3. OPERIMET VFR ....24
10. KOMITETI PËR BUXHET DHE SIGURI ....25
11. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR ....27

12. KORDINIMI CIVIL-USHTARAK ....................28
13. SISTEMI I MENAXHIMIT TË SIGURISË ....................29
13.1. PASQYRA E PERFORMANSËS OPERATIVE DHE REZULTATET E INDIKATORËVE KYÇ TË PERFORMANCËS 30
13.2. ARSYESHMËRIA PËR RRITJEN E NDODHIVE TË RAPORTUARA ....................34
14. SISTEMI I MENAXHIMIT TË CILËSISË....................35
14.1. KONSULTIMI ME SHFYTËZUESIT E SHËRBIMEVE DHE MATJA E KËNAQSHMËRISË ....................37
15. PERFORMANCA FINANCIARE ....................38
15.1. DEKLARATA ....................38
15.2. KOSTOJA E NJËSISË ....................39
15.3. PLANIFIKIMI DHE REALIZIMI I TË HYRAVE....................39
15.4. PASQYRA E PRANIMEVE DHE PAGESAVE NË PARA TË GATSHME....................41
15.5. RAPORTI I EKZEKUTIMIT TE BUXHETIT....................42
15.6. SHPALOSJA E NDARJEVE FILLESTARE DHE FINALE TË BUXHETIT ....................43
15.7. PAGAT DHE SHTESA ....................44
15.8. MALLRA DHE SHËRBIME ....................45
15.9. SHPENZIME KOMUNALE ....................46
15.10. SHPENZIMET KAPITALE ....................47
15.11. TË ARKËTUESHMET....................48
16. RAPORT PËR GJENDJEN/ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT (ZKA)....................49
17. MENAXHIMI I RREZIQEVE TË ORGANIZATËS....................50
18. BURIMET NJERËZORE....................55
18.1. PERSONELI I KANS....................55
19. TRAJNIMET....................57
20. PRIRORITETET PËR 2025 ....................58

# 1. MESAZHI I DREJTORIT

*Të dashur miq dhe bashkëpunëtorë,*

*Kam kënaqësinë të ndaj me ju edhe këtë vit raportin vjetor të KANS (Ofruesit e Shërbimeve të Navigacionit Ajror të Kosovës) përmes të cilit kemi shpalosur informacione kyçe, të cilat pasqyrojnë punën tonë të përbashkët gjatë vitit 2024.*




*KANS me sukses të plotë ka përmbushur detyrat e saj në arritjen e objektivave kryesore të sigurisë dhe krahas kësaj ka zhvilluar dhe implementuar projeksione të rëndësishme strategjike në funskion të përmirësimit të infrastrukturës ligjore, teknike dhe kapaciteteve njerëzore.*

*Përgjatë vitit 2024, KANS në bashkëpunim me autoritetet shtetërore dhe palë tjera të interesit, ka arritur të bëjë ndryshimet e nevojshme të legjislacionit primar, duke asistuar në koncept dokumentin për projektligjin e Ofruesit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror të Kosovës dhe në të gjitha fazat e implementimit të këtij projeksioni, deri në miratimin e projektligjit në Dhjetor të viti 2024.*

*Vlerësojmë se miratimi dhe hyrja në fuqi e këtij ligji shënon vitin 2024, duke hapur rrugë për projekte madhore në interesin e përgjithshëm të Republikës së Kosovës, në interes të ngritjes dhe ruajtjes së sigurisë së trafikut ajror, të shfrytëzuesve të shërbimeve të navigacionit ajror, në lehtësimin e shumë proceseve dhe projekteve në progres dhe gjithsesi në funksion të ngritjes së mirëqenies së personelit të çmuar të KANS.*

*Vlerësojmë përkushtimin maksimal të personelit dhe përkrahjen nga institucionet tona vendore dhe partnerëve tanë të çmuar, me të cilët, në harmoni të plotë dhe të vazhdueshme bashkërenduam veprimet për normalizim të plotë të hapësirës së ulët ajrore, si dhe dizajnuam plane përkatëse për menaxhim të hapësirës së lartë ajrore të Kosovës.*

*Viti 2025 na pret me plane dhe projeksione të rëndësishme dhe ambicioze, që lidhen me hartimin e legjislacionit sekondar që derivon nga Ligjin NR.08/L-305 Për Ofruesin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, arritjen e objektivave specifike të vendosura me Planin e Performancës 2025, si dhe realizimin e të gjitha projekteve dhe aktiviteteve që shkojnë në funksion të përmbushjes së misionit tonë.*

*KANS mbetet e përkushtuar në përmbushjen dhe arritjen e detyrave dhe përgjegjësive të saj, duke garantuar siguri dhe cilësi për gjithë shfrytëzuesit e hapësirës ajrore të Republikës së Kosovës.*

# 2. PROFILI I KOMPANISË



## 2.1. THEMELIMI I OFRUESIT TË SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR (KANS)

KANS është themeluar me datë 27 Dhjetor 2024, me Ligjin NR.08/L-305 Për Ofruesin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror si subjekt i pavarur juridik shtetëror në shërbim të interesit publik, për të siguruar infrastrukturën dhe shërbimet e navigacionit ajror në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës.

KANS ofron shërbimet e navigacionit ajror prej nivelit GND (tokë) deri në FL 205 (6250m) për të gjitha kategoritë e trafikut civil dhe ushtarak.

Të drejtat dhe detyrimet e Republikës së Kosovës si themelues i KANS zbatohen përmes Qeverisë, përkatësisht Këshillit Mbikëqyrës të KANS si organ kryesor që udhëheq me KANS.

## 2.2. STATUSI I OFRUESIT TË SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR

KANS është person juridik publik i themeluar me Ligjin NR.08/L-305 Për Ofruesin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror si person juridik publik i pavarur, jo-fitimprurës, financiarisht autonom dhe i qëndrueshëm, në shërbim të interesit publik.

KANS ka autonomi të plotë operacionale, administrative dhe funksionon jashtë kornizës ligjore të administratës shtetërore dhe zyrtarëve publikë, si dhe nuk konsiderohet organizatë buxhetore në kuptim të Ligjit përkatës për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Ligjin përkatës për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

KANS do të veprojë në pajtim me politikat, legjislacionin, standardet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të zbatueshme për aviacionin civil në Republikën e Kosovës si dhe në përputhje me standardet, praktikat dhe rekomandimet e ICAO-së mbi shërbimet e navigacionit ajror, përmes Rregulloreve të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës.

KANS ka llogari të vetën bankare, në bankat e themeluara në Kosovë si dhe jashtë saj bazuar në obligimet që derivojnë nga institucionet dhe organizatat ndërkombëtare.

Si person juridik i pavarur, KANS ka të drejtë të lidhë kontratë dhe marrëveshje përkatëse, të jetë paditës dhe i paditur dhe të përgjigjet me kapitalin e vet për detyrimet e krijuara nga KANS.

Veprimtaria e KANS-së përkufizohet në katër shërbimet kryesore në vijim. Puna e këtyre shërbimeve mbështetet nga shërbimet e çmuara administrative dhe financiare.
Duke qenë se siguria është objektiv dhe qëllim kryesor i KANS-së, sistemi i menaxhimit të sigurisë mbetet mekanizmi kryesor për ruajtjen, monitorimin dhe ngritjen e sigurisë.

- Shërbimet e Kontrollit të Trafikut Ajror;
- Shërbimet e Informacioneve Aeronuatike;
- Shërbimet Meteorologjike dhe
- Komunikimi/ Navigimi/Vëzhgimi.

KANS ka 158 të punësuar, kryesisht të shkolluar dhe përgatitur në institute të specializuara europiane

# 3. MISIONI DHE VISIONI



# 4. SHËRBIMET KRYESORE

KANS (ASHNA) është e çertifikuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës për shërbimet në vijim:

## 4.1. SHËRBIMET E TRAFIKUT AJROR

- Kontrolli i Trafikut Ajror (ATC)
- Shërbimi i Informacionit të Fluturimit (FIS)
- Shërbimi Këshillues për Trafikun Ajror
- Shërbimi i Alarmimit



## 4.2. SHËRBIMET E INFORMACIONEVE AERONUATIKE

- Publikimi i Informacionit Aeronautik (AIP)
- Procesimi i NOTAM-ëve (NOF)
- Shërbimi raportues Aeronautik (ARO)

## 4.3. SHËRBIMET METEOROLOGJIKE

- Parashikim
- Vrojtim

## 4.4. KOMUNIKIMI/ NAVIGIMI/VËZHGIMI

- Komunikim
- Navigim
- Survejim

# 5. PROJEKTET DHE AKTIVITETET KRYESORE 2024

Në funksion të përmbushjes së misionit dhe vizionit, si dhe objektivave specifike për vitin 2024, kemi zhvilluar dhe realizuar projekte dhe aktivitete të rëndësishme, për të cilat kemi paraqitur në vijim përshkrimet përkatëse rreth progresit dhe statusit të tyre.

## 5.1. LIGJI PËR OFRUESIN E SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT

Përgjatë vitit 2024, KANS në bashkëpunim me autoritetet shtetërore dhe palë tjera të interesit, ka arritur të bëjë ndryshimet e nevojshme të legjislacionit primar, duke asistuar në koncept dokumentin për projektligjin e Ofruesit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror të Kosovës dhe në të gjitha fazat e implementimit të këtij projeksioni, deri në miratimin e projektligjit në Dhjetor të viti 2024.

## 5.2. NORMALIZIMI I HAPËSIRËS (ULËT) AJRORE

Në kuadër të normalizimit të hapësirës ajrore të Kosovës, bazuar në planet strategjike dhe Planin e Performancës 2024, KANS ka zhvilluar projekte, takime dhe angazhime tjera specifike në arritjen e këtij objektivi.

Ndër projektet kryesore që lidhen me këtë objektiv janë implementimi i sistemit ATM, i cili është në progres sipas planit, si dhe shkollimi i 12 kontrollorëve të trafikut ajror për Area Control Survelliance (ASC).



Në koordinim dhe së bashku me autoritetet e MMPHI janë zhvilluar takime me autoritetet e NATOs dhe Malit të Zi, për hapjen e rrugëve ajrore me Malin e Zi, si dhe për perspektivën në menaxhimin e hapësirës ajrore të Kosovës nga autoritetet vendore.

Përkundër zotimeve dhe dakordimeve të arritura në takimet me autoritetet malazeze, për të avancuar në hapjen e rrugëve ajrore mes nesh, e që pritej të kapitalizohej me nënshkrimin e Letër Marrëveshjes (LoA) për koordinim të trafikut mes Prishtina APP dhe Podgorica APP, e dakorduar kohë më parë, qeveria e re Malit të Zi nuk ka reaguar në vazhdimin e këtij bashkëpunimi, përkatësisht nuk kemi marrë ndonjë përgjigje për nënshkrimin e LoAs.

## 5.3. IMPLEMENTIMI I SISTEMIT PËR MENAXHIMIN E TRAFIKUT AJROR (ATM)

Në fushën e navigacionit ajror dhe në përgjithësi në industrinë e aviacionit civil, përdoren sisteme komplekse softuerike/harduerike. Për më shumë, kjo industri zhvillohet me hapa të shpejtë dhe është e domosdoshme përcjellja dhe arritja e këtyre trendeve të zhvillimit.



Shtetet përmes ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror, i kushtojnë rëndësi të veçantë investimit dhe zhvillimit të sistemeve të navigacionit ajror, për arsye sigurie dhe për të rritur cilësinë e shërbimeve përkatëse. Në kuadër të arritjes së këtij objektivi, ASHNA përmes Planit të perofrmancës 2024, ka planifikuar tri aktivitete kryesore, për të cilat në vijim kemi paraqitur statusin e progresit për perudhën raportuese.

Ky projekt është ndër treguesit kryesor në arritjen e Objektivit 2 Përmirësimi dhe modernizimi i sistemeve të navigacionit ajror.Kontrata për sistemi e ri ATM është lidhur në vitin 2023, me kohëzgjatje implementimi deri në vitin 2026. Sipas Planit të Performancës 2024, kanë qenë të planifikuara aktivitetet në vijim:

- Ri-konstruktimi i sallës operative për Njësinë Vajtje-Ardhje (APP) dhe Njësinë e Kontrollit të Hapësirës së Lartë Ajrore (ACC);
- Furnizimi dhe instalimi i konzolave operative (ATM;)
- Trajnimi i kontrollorëve të trafikut ajror për vrojtim/kontrollë të hapësirës ajrore (ACS).

### 5.3.1. AKTIVITETET E REALIZUARA

- Ka përfunduar Ri-konstruktimi i sallës operative për Njësinë Vajtje-Ardhje (APP) dhe Njësinë e Kontrollit të Hapësirës së Lartë Ajrore (ACC);
- Ka përfunduar furnizimi i konzolave operative (ATM);
- Janë trajnuar 12 ( II grupe) kontrollorë të trafikut ajror për Vrojtim/ Kontrollë i Hapësirës Ajrore (Area Control Survelliance-ACS);
- Është përfunduar sesioni i FAT TWR per ATM;
- Është përfunduar trajnimi i Inspektoreve të ASHNA për FAT dhe SAT.

### 5.3.2. RREZIQET E IDENTIFIKUARA DHE VEPRIMET E NDËRRMARA

- Sanksionet e BE, që për momentin pamundësojnë sigurimin e pasijeve jetike për sistemin e ri, si dhe kufizojnë çasjen në shërbimet e ofruara nga Eurocontrol;
- Ende nuk është siguruar nga Eurocontrol licenca për ARTAS, për shkak të saknsioneve në fuqi.

ARTAS është pajisje e rëndësishme për grumbullimin e të dhënave radarike. Licenca për këtë pajisje lëshohet nga Eurcontroli. KANS (ASHNA) në koordinim me MMPHI dhe palë tjera të interesit, e ka adresuar këtë vështirësi edhe me autoritetet e NATOs, ICETRA, në mënyrë që të mundësohet licenca për ARTAS.

## 5.4. PËRMIRËSIMI (UPGRADE) I RADARIT TË GOLESHIT

Sistemi i survejimit radarik sekondar MSSR Mode S është instaluar në Golesh dhe është operativ nga muaji maj i vitit 2013. MSSR Mode S përdoret për të siguruar detektimin e fluturakeve në hapësirën e ulët ajrore të Republikës së Kosovës.

Të dhënat e radarit sekondar MSSR Mode S poashtu shfrytëzohen edhe për distribuimin e të dhënave radarike nga Hungaro-Control për qëllime të kontrollit të hapsirës së lartë ajrore dhe mundëson që në të ardhmen këto të dhëna radarike të shkëmbehen edhe me shtetet fqinje me interes të përbashkët, për të ngritur cilsinë dhe sigurinë e trafikut ajror.



Që të arrihen këto qëllime dhe të sigurohet ambient i sigurtë në ofrimin e shërbimeve radarike, janë paraparë disa faza të mirëmbajtjes mekanike dhe elektronike, të cilat janë të sistemuara në nivele të ndryshme të mirëmbajtjes.
Në kuadër të kësaj, KANS (ASHNA) ka planifkuar projektin për përmirësimin (upgrade) të radarit të Goleshit (MSSR Mode S).

### 5.4.1. AKTIVITETET E REALIZUARA

- Zhvillimi i procedurave të prokurimit;
- Nënshkrimi i kontratës;
- Implementimi i kontratës.

Gjatë periudhës raportuese, zhvillimi i procedurave të prokurimit për përmirësim (upgrade) të radarit të Goleshit ka përfunduar, është nënshkruar kontrata dhe ka filluar implentimi i kontratës. Testimet pranuese te prodhuesi (FAT Factory Acceptance Test) ka përfunduar, përderisa testimet pranuese në lokacion do zhvillohen në vitin 2025.

## 5.5. MARRËVESHJET E NIVELIT TË SHËRBIMIT (SLA)

SLA janë marrëveshje për mirëmbajtje të sistemeve dhe paijseve specifike të navigacionit ajror, që kryhen nga prodhuesi apo përfaqësuesi i autorizuar i prodhuesit. KANS (ASHNA) ka planifikuar aktivitetet në vijim:

- Zhvillimi i procedurave të prokurimit
- Nënshkrimi i kontratës
- Implementimi i kontratës

Gjatë periudhës raportuese, zhvillimi i procedurave të prokurimit për SLA janë përfunduar, janë nënshkruar tri kontrata (SLA për sistemin për parashikim të motit, SLA për sistemin VCSS dhe SLA pëe ILS), ndërsa ka filluar implementimi i dy kontratave. SLA kontrata nis implementimin pas nënshkrimit të Aneks kontratës.



## 5.6. SHFRYTËZIMI I BURIMEVE NATYRORE TË ENERGJISË

Në linjë me Strategjinë e Energjisë 2022-2031, ASHNA synon shfrytëzimin optimal të burimeve natyrore të energjisë. Për vitin 2024 ka qenë i planifikuar aktiviteti në vijim:

### 5.6.1. ZHVILLIMI I PROCEDURAVE TË PROKURIMIT

Janë zhvilluar procedurat e prokurimit dhe është publikuar tenderi në afat ligjor. Për këtë aktivitet janë pranuar 4 oferta dhe pas përfundimit të hapjes dhe vlerësimit të ofertave, është shpallur fituesi. Pas pranimit të një kërkese për rishqyrtim, ASHNA rikthen aktivitetin në rivlerësim.



Komisioni ri-vlerësues ka rekomanduar anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit, në mungesë të ofertave të përgjegjshme.

Një operator ekonomik ka dorëzuar kërkese për rishqyrtim kunder vendimit për anulim, të cilën ASHNA e ka cilësuar të pabazuar lidhur me pretendimet ankimor.

Operatori Ekonomik, në afatin ligjor ka dorëzuar ankesë në OSHP. ASHNA ka pranuar ekspertizën e ekspertit shqyrtyes të caktuar nga OSHP dhe është pajtuar me mendimin e ekspertit shqyrtues, i cili i jep të jep të drejtë ASHNA-s në marrjen e vendimit për anulim.

Në Qershor të vitit 2024, OSHP ka marrë vendim për anulimin e aktitvitetit. Pas këtij vendimi, është iniciuar Deklarata për re-tender dhe është njoftuar AQP për inicimin e projektit të paplanifikuar, meqenëse ka qenë në proces e sipër në kohën e hartimit të Planifikimit të Prokurimit për vitin fiskal 2024.

Është rishpallur tenderi, janë vlerësuar ofertat dhe është përzgjedhur operatori ekonomik,

Gjatë afatit për ankimime, Operatori Ekonomik ka adresuar ankesë te OSHP.

Deri në fund të vitit 2024 KANS (ASHNA) nuk ka pranuar përgjigje/vendim nga OSHP.



## 5.7. NGRITJA E KAPACITETEVE NJERËZORE

Kapacitet njerëzore janë përcaktues kryesor i performancës dhe faktor kyq në arritjen e objektivave dhe misionit të KANS. Përveç ruajtjes dhe rritjes së nivelit të sigurisë , KANS ka mision edhe normalizimin e plotë të hapësirës ajrore të Kosovës. Në fuksionin të përmbushjes së këtij misionI, për vitin 2024 kemi planifikuar të fillojmë me procesin e rekrutimit dhe shkollimit 12 Kontrollorëve të Trafikut Ajror.

### 5.7.1. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA DHE TË REALIZUARA

- Rekrutimi i 12 Kandidatëve për Studentë Kontrollorë të Trafikut Ajror;
- Shkollimi 12 Kandidatëve për Studentë Kontrollorë të Trafikut Ajror.

Ky objektiv nuk është arritur për shkak të mospërfshirjes së koeficientit për kandidat/student-kontrollor të trafikut ajror në ligjin e ri për paga.
Ligji i ri i pagave nuk e ka përfshirë koeficientin për pozitën/funskisonin Kandidat Student Kontrollor i Trafikut Ajror dhe rrjedhimisht edhe nuk kemi mundur të iniciojme procesin e rekrutimit. Ky shqetësim është adresuar me shkrim te DMZP. Shkresa ka adresuar caktimin e koeficientit dhe përfshirjen në SIMBNJ sistem softuerik i DMZP-s për menaxhimin e burimeve njerëzore.



Vonesat në përgatitjen e 12 Kontrollorëve të rinjë të trafikut ajror, mund ta prekin edhe projektin e marrjes në menaxhim të hapësirës së lartë ajrore. Ky projekt, lidhet njëkohësisht edhe me misionin e ASHNA-s dhe synimet e Qeverisë së Kosovës, të shprehura edhe përmes Planeve Kombëtare Zhvillimore. Kapacitetet e mjaftueshme njerëzore, janë ndër faktorët determinues në përmbushjen e këtij misioni.

Si pjesë e procesit të selektimit/përzgjedhjes së kandidatëve të përgjegjshëm, ASHNA aplikon një test të quajtur FEAST (First European Air Traffic Controller Selection Test) i akredituar dhe i njohur ndërkombëtarisht, për të bërë vlerësimin përkatës të kandidatëve në fusha të caktuara. Është perzgjedhur institucioni i cili do kryej FEAST-in dhe është nënshkruar kontrata.

## 5.8. ISO ÇERTIFIKIMI




KANS ka bërë kontrollin e dokumenteve në aspektin e cilësisë në kuadër të përgatitjeve për certifikim me ISO 9001:2015

Gjatë periudhës raportuese është zhvilluar Manuali i Cilësisë në formatin e standardit ISO 9001:2015.

Përbërja e materialit është e orientuar në formatin e standardit dhe duke u përshtatur me klauzolat e standardit. Formati i ri i Manualit është bazë për implementimin e standardit, për krijimin dhe adaptimin e dokumenteve të njësive tjera në KANS, si dhe udhërrëfyes i rëndësishëm për auditimin e brendshëm në aspketin parapërgaditor për çertifikim me ISO 9001:2015.

### 5.8.1. AUDITIMI I BRENDSHËM PËR ISO 9001:2015

Auditorët e çertifikuar për auditim të brendshëm për ISO 9001:2015 në KANS, kanë zhvilluar auditimin përkatës.
Është shpërndarë "Plani i veprimit të menaxhmentit" dhe aktivitetet janë përfunduar pjesërisht.
Në këtë proces pritet vlersimi i auditorëve të brendshëm për përmbushjen e aktiviteteve në planin e veprimit nga njësitë.

### 5.8.2. AUDITIMI I JASHTËM DHE ÇERTIFIKIMI ME ISO 9001:2015

Periudha raportuese mbulon edhe procesin e angazhmit të një kompanie për çertifikimin e ASHNA me ISO 9001:2015.
Pasi që ky proces do të duhej të bëhej me procedurë të prokurimit, është dorëzuar deklarata e nevojave dhe specifikat në DPRK. Sipas raporteve nga DPRK tenderimi i parë ka dështuar sepse nuk ka pasur konkurrues të përgjegjshëm ndërsa ritenderimi është në proces.

### 5.8.3. TRAJNIMET E ZHVILLUARA PËR ISO 9001:2015

Është zhvilluar pakoja e trajnimeve për Auditorët e brendshëm dhe anëtarët ë Ekipit ISO.

- Trajnimi i përgjithshëm për iso 9001:2015;
- Trajnimi i përgjithshëm për iso 14001:2015;
- Trajnimi për auditor të brendshëm.

# 6. PLANET STRATEGJIKE

Bazuar në rregullativin përkatës për planet vjetore të punës dhe ato strategjike, gjatë vitit 2024 janë hartuar dokumentet në vijim:

- Planet e Biznesit 1 dhe 5 vjeçar;
- Planifikimet Buxhetore;
- Plani i Performancës 2025;
- Plani Vjetor i Punës 2025;
- Menaxhimi i Rrezikut;
- Plani i Integritetit;
- Planit i Privatësisë.



# 7. AUDITET

KANS është subjekt i auditeve të ndryshme dhe të vazhdueshme të paraqitura në vijim:

## 7.1. AUDITET E BRENDSHME SIGURISË

Auditi është metodologji proaktive për identifikimin e rreziqeve/hazardeve të mundshme dhe bënë pjesë në burimet e brendshme të identifikimit të rreziqeve/hazardeve.
Procesi për auditim të brendshëm detajon rrjedhën e hapave gjatë auditimit, duke përfshirë kërkesën që programi i auditimit duhet të planifikohet, duke marrë parasysh statusin dhe rëndësinë e proceseve që auditohen, si dhe rezultatet e auditimeve të mëhershme. Kriteret e auditimit, fushëveprimi, frekuenca dhe metodat duhet të jenë të definuara. Zgjedhja e auditorëve dhe auditimi si tërësi duhet të sigurojë objektivitet dhe paanësi.
Drejtori i KANS është përgjegjës për programin e auditimit të brendshëm, këtë përgjegjësi të kryerjes së auditimeve të sigurisë e delegon tek Departamenti DCSS-së. Raportimi i rezultateve të auditimit tek Drejtori i KANS do të bëhet pas përfundimit të procesit të auditimit të brendshëm.

Divizioni i Sigurisë në muajin Dhjetor të vitit 2023 ka përgaditur planin e Auditeve te Sigurisë për vitin vijues. Me poshtë eshte paraqitur ne form tabelare planifikimi i auditimit në departamentet përkatëse.

Divizioni i Sigurisë gjatë muajit Janar 2024 ka shpërndarë planin e Auditimeve të Sigurisë te Menaxheret e departamenteve DTEK, DAIS, DMET dhe DATS. Është me rëndësi te potencohet fakti se për shkak të angazhimeve të shumta të zyrtarve të departamenteve përkatëse që lidhen me procesin e ndryshimeve, përkatësisht implementimin e tyre, jemi dakorduar që zbatimi i auditimeve të realizohet në momente më të përshtatshme që mund të mos jenë në përputhje me planifikimin.

- Auditimin e Sigurisë në DTEK eshte realizuar në datat 08-09 Shkurt 2024;
- Auditimin e Sigurisë në DAIS eshte realizuar në datat 04-05 Mars 2024;
- Auditimin e Sigurisë në MET eshte realizuar në datat 02-03 Prill 2024;
- Auditimin e Sigurisë në DATS eshte realizuar në datë 16 Qershor 2024.

## 7.2. AUDITET E JASHTME TË SIGURISË

Auditet e jashtme të sigurisë në KANS zhvillohen nga Autoriteti i Aviaionit Civil i Kosovës. Gjatë vitit 2024 janë realizuar auditet në vijim:

Auditimin e Sigurisë më 25-29 mars 2024;
Auditimin e Sigurisë 29-30 prill 2024;

Auditimin e Sigurisë 18-21 qershor 2024;

Auditimin e Sigurisë 25-29 nëntor 2024.

## 7.3. AUDITET E NJAB

Gjatë vitit 2024, Njësia e Auditimit të Brendshëm sipas planit ka realizuar 6 (gjashtë) auditime të brendshme si në vijim:

- Sistemi i avanceve për udhëtime zyrtare dhe i parasë së gatshme;
- Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore, rekrutimi dhe avancimi i stafit;
- Sistemi i planifikimit të procedurave të prokurimit;
- Sistemi për menaxhimin e kontratave;
- Sistemi i pagesave për mallra, shërbime dhe punë;
- Sistemi i menaxhimit e pagave, shtesave në paga dhe kompenzimeve.



# 8. STRUKTURA ORGANIZATIVE

Gjatë periudhës raportuese, KANS ka funksionuar sipas organogramit në vijim. Në kohën kur po gjenerohet ky raport, KANS është duke përgatitur aktet përkatëse nënligjore që derivojnë nga Ligji NR.08/L-305 Për Ofruesin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, përmes të cilave do bëhen azhurnimet e nevojshme në strukturën organizative të KANS.



# 9. RRJEDHA E TRAFIKUT AJROR

Viti 2024 është shënuar me rritje të numrit të fluturimeve komerciale prej 22.2%, që nënkupton 26670 operime ajrore komerciale, 1097 ushtarake dhe 3736 të tjera (GAT/VFR).

Të gjitha këto operime janë zhvilluar në përputhmëri të plotë me rregullativin vendor dhe ndërkombëtar.Vlen të theksohet se ky trafik është realizuar rrjedhshëm, me efikasitet të plotë dhe duke ruajtur nivelet e sigurisë edhe në kushtet e punimeve në progres të projektit të zgjatjes së pistës.

Në vijim kemi paraqitur të detajuara raportet statistikore për çdo kategori trafiku ajror, duke i krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

## 9.1. OPERIMET KOMERCIALE

| **OPERIMET KOMERCIALE 2023 – 2024** | | | **Krahasimi me vitin paraprak** | |
|---|---|---|---|---|
| **Muaji** | **2023** | **2024** | **Nr. i operimeve** | **Përqindja** |
| Janar | 1652 | 2018 | 366 | 22.2% |
| Shkurt | 1231 | 1571 | 340 | 27.6% |
| Mars | 1523 | 1847 | 324 | 21.3% |
| Prill | 1988 | 2013 | 25 | 1.3% |
| Maj | 2033 | 2037 | 4 | 0.2% |
| Qershor | 2027 | 2248 | 221 | 10.9% |
| Korrik | 2726 | 2964 | 238 | 8.7% |
| Gusht | 2705 | 3035 | 330 | 12.2% |
| Shtator | 2018 | 2129 | 111 | 5.5% |
| Tetor | 1827 | 2329 | 502 | 27.5% |
| Nentor | 1453 | 2036 | 583 | 40.1% |
| Dhjetor | 1899 | 2443 | 544 | 28.6% |
| **TOTAL** | **23082** | **26670** | **3588** | **15.5%** |

**Tabela 1. Operimet komerciale gjatë vitit 2024 dhe krahasimi me vitin paraprak**




| | JANAR | SHKURT | MARS | PRILL | MAJ | QERSHOR | KORRIK | GUSHT | SHTATOR | TETOR | NENTOR | DHJETOR |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2023 | 1652 | 1231 | 1523 | 1988 | 2033 | 2027 | 2726 | 2705 | 2018 | 1827 | 1453 | 1899 |
| 2024 | 2018 | 1571 | 1847 | 2013 | 2037 | 2248 | 2964 | 3035 | 2129 | 2329 | 2036 | 2443 |



## 9.2. OPERIMET USHTARAKE

| OPERIMET USHTARAKE 2023 - 2024 | | | Krahasimi me vitin paraprak | |
|---|---|---|---|---|
| **Muaji** | **2023** | **2024** | **Nr. i operimeve** | **Përqindja** |
| Janar | 111 | 88 | -23 | -20.7% |
| Shkurt | 80 | 89 | 9 | 11.3% |
| Mars | 99 | 84 | -15 | -15.2% |
| Prill | 84 | 83 | -1 | -1.2% |
| Maj | 98 | 85 | -13 | -13.3% |
| Qershor | 115 | 90 | -25 | -21.7% |
| Korrik | 103 | 89 | -14 | -13.6% |
| Gusht | 102 | 102 | 0 | 0.0% |
| Shtator | 104 | 87 | -17 | -16.3% |
| Tetor | 59 | 125 | 66 | 111.9% |
| Nentor | 59 | 86 | 27 | 45.8% |
| Dhjetor | 61 | 89 | 28 | 45.9% |
| **TOTAL** | **1075** | **1097** | **22** | **2.0%** |

**Tabela 2. Operimet ushtarake gjatë vitit 2024 dhe krahasimi me vitin paraprak**




| | JANAR | SHKURT | MARS | PRILL | MAJ | QERSHOR | KORRIK | GUSHT | SHTATOR | TETOR | NENTOR | DHJETOR |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2023 | 111 | 80 | 99 | 84 | 98 | 115 | 103 | 102 | 104 | 59 | 59 | 61 |
| 2024 | 88 | 89 | 84 | 83 | 85 | 90 | 89 | 102 | 87 | 125 | 86 | 89 |



## 9.3. OPERIMET VFR

| OPERIMET TJERA VFR 2023 - 2024 | | | Krahasimi me vitin paraprak | |
|---|---|---|---|---|
| | **2023** | **2024** | **Nr. i operimeve** | **Përqindja** |
| Janar | 319 | 296 | -23 | -7.2% |
| Shkurt | 249 | 342 | 93 | 37.3% |
| Mars | 288 | 278 | -10 | -3.5% |
| Prill | 250 | 323 | 73 | 29.2% |
| Maj | 383 | 298 | -85 | -22.2% |
| Qershor | 338 | 314 | -24 | -7.1% |
| Korrik | 268 | 335 | 67 | 25.0% |
| Gusht | 171 | 297 | 126 | 73.7% |
| Shtator | 108 | 343 | 235 | 217.6% |
| Tetor | 268 | 383 | 115 | 42.9% |
| Nentor | 191 | 260 | 69 | 36.1% |
| Dhjetor | 157 | 267 | 110 | 70.1% |
| **TOTAL** | **2990** | **3736** | **746** | **24.9%** |

**Tabela 3. Operimet VFR gjatë vitit 2024 dhe krahasimi me vitin paraprak**



# 10. KOMITETI PËR BUXHET DHE SIGURI

Komiteti për Buxhet dhe Siguri (KBS) është organi më i lartë i ASHNA-s dhe ka përgjegjësinë për miratimin e dokumenteve dhe vendimeve të rëndësishme lidhur me buxhetin dhe sigurinë. Ky komitet siguron një menaxhim të duhur të resurseve financiare dhe sigurisë në shërbi-met e navigacionit ajror.

Komiteti për Buxhet dhe Siguri (KBS) përbëhet nga anëtarët si vijon:

- Drejtori i ASHNA-s – Kryesues;
- Zëvendësdrejtori për Shërbime Operative (ZVOP) – Zëvendës Kryesues / Anëtar;
- Zëvendësdrejtori për Shërbime Administrative dhe Financa (ZVAF) – Zëvendës Kryesues / Anëtar;
- Menaxheri i DCSS – Anëtar;
- Menaxheri i ZYDR – Anëtar;
- Menaxheri i DTEK – Anëtar;
- Menaxheri i DZHT – Anëtar;
- Menaxheri i DBNJ – Anëtar;
- Menaxheri i DPRK – Anëtar;
- Sekretari i KBS – Anëtar.

Gjatë vitit 2024, Komiteti për Buxhet dhe Siguri ka mbajtur gjithsej 3 takime, ku janë diskutuara dhe aprovuar raportet e punës të departamenteve dhe dokumente të tjera që kërkojnë miratim.

**Takimi i parë - Data: 26.02.2024**

Në këtë takim u shqyrtuan dhe u miratuan:

- Procesverbali i Takimit 42-të të vitit 2023.
- Raportet vjetore të punës për departamentet për vitin 2023, të cilat përmbanin arritjet, sfidat dhe planet e secilit departament për vitin në vijim.

**Takimi i dytë - Data: 03.06.2024**

Në këtë takim u shqyrtuan dhe u miratuan:

- Procesverbali i Takimit 43-të të vitit 2024.
- Raportet e departamenteve për tre mujorin e parë të vitit 2024, ku secili departament para-qiti rezultatet dhe përpjekjet e tij gjatë kësaj periudhe, duke evidentuar arritjet dhe sfidat që janë hasur gjatë këtij periudhe.

**Takimi i tretë - Data: 26.12.2024**

Në këtë takim u shqyrtuan dhe u miratuan:

- Procesverbali i Takimit 44-të të vitit 2024;
- Raportet e departamenteve për tre mujorin e tretë të vitit 2024, ku secili departament bëri një përmbledhje të aktiviteteve dhe rezultateve të tij për këtë periudhë;
- Rishikimi i Menaxhmentit, i cili përfshiu;
- Rezultatet nga auditimet e brendshme;

- Auditet e Sigurisë;
- Auditet e Cilësisë;
- Auditet e NJAB;
- Rezultatet nga auditimet tjera që i janë bërë ASHNA-s;
- Auditet e AAC-së;
- Auditet e MPB-së;
- Reagimi (feedback) i shfrytëzuesve dhe matja e kënaqshmërisë;
- Performanca e sistemeve / Pajisjeve;
- Gjendja e veprimeve korrigjuese dhe parandaluese, përfshirë hazardet;
- Veprimet pasuese nga rishikimet e mëparshme të menaxhimit;
- Ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e menaxhimit të cilësisë;
- Rekomandimet për përmirësime;
- Aprovimi i planeve për vitin 2025;
- Planin e anketimeve të sigurisë për vitin 2025;
- Planin e auditeve të cilësisë për vitin 2025;
- Planin e auditeve të sigurisë për vitin 2025.



# 11. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Në fushën e navigacionit ajror, për shkak të fushëveprimit dhe specifikave tjera, e në vecanti për shkak të kufizimeve në shtrirjen e menaxhimit të trafikut ajror në Kosovë, bashkëpunimi ndërkombëtar mbetet ndër fushat të cilës i kushtohet rëndesi dhe angazhim i vecantë në të gjitha nivelet.

Përvec takimeve dhe komunikimeve që gjatë vitit zhvillohen në funksion të përcjelljes së trendeve të zhvillimit në teknologjinë e fushës, normalizimi i hapësirës ajrore të Kosovës ishte tema kryesore në takimet dhe angazhimet e KANS edhe gjatë vitit 2024.

### Vizita ne Panairin e Aviacionit ne Gjenevë

Në mënyrë që të njoftohemi me më të rejat nga fusha e aviacionit, kemi marrë pjesë në këtë panairin vjetor të aviacionit, i cili është mbajtur në Gjenevë, Zvicërr. Kjo vizitë ka qenë e karakterit profesional dhe në të njejtën kohë ka shërbyer që të shkëmbejmë kontakte me shumë kompani prestigjioze të aviacionit. Për më shumë, kjo vizitë është shfrytëzuar që të sigurojmë kontakte me disa institute të trajnimit, me të cilët synojmë të lidhim ura të bashkëpunimit në të ardhmen.

### Vizitë vlerësuese nga ICETRA

Vizita u realizua duke iu referuar marrëveshjes ndërmjet Forcave të Sigurisë së Kosovës (KFOR) dhe Islandës, dhe memorandumit pasues ndërmjet Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës (AACK) dhe Autoritetit Islandez të Transportit (ICETRA). Me këtë rast, jemi përgjigjur në pyetjet e inspektorëve të ICETRA në lidhje me sistemin e sigurisë në ASHNA dhe me kërkesë të ICETRA është inspektuar objekti i ri i rrymës përkatësisht është inspektuar ndryshimi i koduar PSF18-021-SAA_Sistemi i furnizimit me energji elektrike.

### Takimi me NATO dhe me Malin e Zi

Në kuadër të normalizimit të hapsësirës ajrore të Kosovës, KANS (ASHNA) më 25 qershor 2024, bashkë me përfaqësues të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, kanë zhvilluar një vizitë pune në NATO. Takimi ka qenë i aranzhuar nga Përfaqësuesi i Kosovës në NATO.

KANS ka zhvilluar komunikim dhe koordinim të vazhdueshëm me MMPHI në çështjen e normalizimit të hapësirës ajrore, me theks të veçantë për hapjen e rrugëve ajrore me Malin e Zi. Janë zhvilluar takime dhe me Zv. Kryeministrin e Malit te Zi dhe Ministrin e Punëve të Jashtme të Malit të Zi.

# 12. KORDINIMI CIVIL-USHTARAK

Në vitin 2024 kemi pasur takime të rregullta me FSK-në. KANS Kanë qenë kryesisht të inkuadruar në asistimin dhe mbështetjen e FSK-së për zhvillimin e kapaciteteve të tyre në fushën e aviacionit.

Me iniciativën e KFOR-it amerikan nga Bondsteel-i, kemi krijuar një grup punues në mes të ASHNA-së (departamenti i Meteorologjisë) dhe FSK-së për hartimin e një projekti për zhvillimin e një shërbimi meteorologjik në aeroportin e Gjakoves. Ky projekt i është dorëzuar FSK-së dhe aktualisht është në fazën e shqyrtimit.

Poashtu kemi qenë të involvuar në grupin punues ASHNA - FSK – KFOR, për dizajnimin dhe miratimin e hapësirave të reja (ROZ) për nevojat ushtarake.

Kemi bërë një vlerësim të sigurisë të përbashkët me LKIA në lidhje me përdorimin e aeroportit të Prishtinës si aeroport alternativ për dronët e FSK-së.

Janë zhvilluar takime KANS, LKIA dhe FSK, në lidhje me planin për shfrytëzimin e aeroportit të Prishtinës për aterrime emergjente të dronëve dhe është bërë rishikimi i draft marrëveshjes në mes të LKIA dhe FSK.



# 13. SISTEMI I MENAXHIMIT TË SIGURISË

KANS (ASHNA) duke zbatuar proceduarat e Manualit për Menaxhimin e Sigurisë, Cilësisë dhe Sigurimit ka realizuar detyrat dhe përgjegjësitë e parapara në Planin e Punës për vitin 2024.

Viti 2024 është karakterizuar me proceset e implementimit te sistemeve/pajisjeve të reja në kuadër të projektit ATM.

Janë inicuar dhe realizuar vlerësimet e sigurisë:

- PSF24-001-SAA Renovimi Hapsirave te DMET dhe DAIS;
- PSF24-002-SAA KVM Switch ne DMET;
- PSF24-003-SAA Minimum Staff Required in DTEK;
- PSF24-004-SAA KSF UAV Operations.

Natyrisht sfida të cilat lidhen me menaxhimin e ndryshimeve, trajtimin e ndodhive dhe hazadreve, hetimet e sigurisë janë menaxhuar me angazhimin e përbashkët të të gjithë personelit të KANS dhe me krijimin e një kulture pozitive të sigurisë.

Duke u mbështetur në kapacitetet profesionale dhe vullnetin tonë të përgjithshëm, duke respektuar normat dhe procedurat perkatese te funksionimit përmes veprimeve proaktive dhe reaktive, KANS ka arritur të mbajmë një klimë pozitive të sigurisë, ku i gjithë personeli i KANS ndihet përgjegjës, duke konsideruar çdo ndikim të mundshëm, me qëllim që shërbimet të cilat ofrohen nga KANS, të jenë në përputhje me standardet e kërkuara.



## 13.1. PASQYRA E PERFORMANSËS OPERATIVE DHE REZULTATET E INDIKATORËVE KYÇ TË PERFORMANCËS

Pasqyra e performansës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performansës në aspektin e Sigurisë së KANS janë paraqitur në formë të Aneksit 1 të këtij Raporti. Në këtë Aneks është paraqitur performansa e Sigurisë kundrejt caqeve të sigurisë.
Në përgjithësi në departamentin e DCSS janë regjistruar:







| | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| MOR "A" | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| MOR "B" (inc) | 5 | 7 | 7 | 6 | 1 | 6 | 7 | 6 | 4 |
| MOR "B"(sepp. Loss) | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 |
| MOR "C" | 56 | 55 | 56 | 67 | 58 | 103 | 135 | 151 | 85 |
| MOR"D" | 64 | 71 | 65 | 73 | 33 | 60 | 57 | 99 | 97 |

## Raportimet sipas departamenteve



| | DATS | DTEK | DAIS | DMET |
|---|---|---|---|---|
| MOR "A" | 0 | 0 | 0 | 0 |
| MOR "B" (inc) | 4 | 0 | 0 | 0 |
| MOR "B"(sepp. Loss) | 0 | 0 | 0 | 0 |
| MOR "C" | 24 | 13 | 7 | 52 |
| MOR"D" | 94 | 0 | 7 | 0 |

MOR "A" MOR "B" (inc) MOR "B"(sepp. Loss) MOR "C" MOR"D"

## Raportimet sipas muajve për vitin 2024



| | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| MOR "A" | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| MOR "B" (inc) | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 | 2 | 0 | 0 |
| MOR "B"(sepp. Loss) | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| MOR "C" | 5 | 7 | 8 | 6 | 8 | 10 | 12 | 11 | 7 | 0 | 7 | 4 |
| MOR"D" | 6 | 6 | 8 | 8 | 9 | 9 | 6 | 13 | 14 | 12 | 2 | 4 |

MOR "A" MOR "B" (inc) MOR "B"(sepp. Loss) MOR "C" MOR"D"

## 13.1.1. CAQET DHE TREGUESIT KYÇ TË PERFORMANSËS SË SIGURISË PËR VITIN 2024

| Nr | Indikatori | Totali 2024 | Totali 2023 | Treguesi i sigurisë | Caqet e performansës së sigurisë për vitin 2024 |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Incidentet me ndikim të Menaxhimit të trafikut ajror (ATM) | 4 | 8 | Numri i incidenteve me ndikim të Menaxhimit të Trafikut Ajror (ATM) | Numri i incidenteve me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 10 incidente në vit. |
| 2 | Dështimi i funksionit të Navigimit | 1 | 9 | Numri i dështimeve të funksionit të Navigimit me ndikim të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të zvogëlohet | Numri i ndodhive të dështimit të funksionit të Navigimit me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 4 dështime në vit. |
| 3 | Dështimi i funksionit të Survejimit | 2 | 7 | Numri i dështimeve të funksionit të Navigimit me ndikim të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të zvogëlohet | Numri i ndodhive të dështimit të funksionit të Survejimit me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 3 dështime apo 50 orë në vit, përfshi këtu edhe ndërprerjet për mirëmbjatje të planifikuar |
| 4 | Dështimi i funksionit të Komunikimit | 9 | 20 | Numri i dështimeve të funksionit të Komunikimit me ndikim të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të zvogëlohet | Numri i ndodhive të dështimit të funksionit të Komunikimit me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 10 dështime në vit. |
| 5 | Dështimi i funksionit ndihmës të informimit | 48 | 32 | Numri i dështimeve të funksionit Ndihmës të informimit duhet të zvogëlohet | Numri i ndodhive të dështimit të funksionit të funksionit ndihmes te informimit me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 20 dështime në vit. |
| 6 | Dështimi i funksioneve të procesimit të të dhënave | 20 | 83 | Numri i dështimeve të funksionit procesimit te te dhenave duhet të zvogëlohet | Numri i ndodhive të dështimit të funksionit të Procesimit të të dhënave me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 50 dështime në vit. |
| 7 | Të tjera | 5 | 0 | Numri i dështimeve tjera duhet të zvogëlohet | Numri i ndodhive të dështimit të funksioneve tjera me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 10 në vit. |
| **Totali** | | **89** | **159** | | |

| Nr | Indikatori | 2024 | 2023 | 2022 | 2021 | 2020 | 2019 | 2018 | 2017 | 2016 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Incidentet me ndikim të Menaxhimit të trafikut ajror (ATM) | 4 | 8 | 8 | 6 | 0 | 7 | 7 | 7 | 5 |
| 2 | Dështimi i funksionit të Navigimit | 1 | 9 | 4 | 8 | 4 | 2 | 2 | 2 | 1 |
| 3 | Dështimi i funksionit të Survejimit | 2 | 7 | 0 | 19 | 7 | 18 | 5 | 1 | 20 |
| 4 | Dështimi i funksionit të Komunikimit | 9 | 20 | 24 | 32 | 19 | 11 | 9 | 14 | 6 |
| 5 | Dështimi i funksionit ndihmës të informimit | 48 | 32 | 49 | 17 | 13 | 23 | 35 | 24 | 16 |
| 6 | Dështimi i funksioneve të procesimit të të dhënave | 20 | 83 | 51 | 20 | 9 | 9 | 5 | 7 | 10 |
| 7 | Të tjera | 5 | 0 | 6 | 7 | 6 | 4 | 2 | 7 | 5 |
| | **TOTALI** | **89** | **159** | **142** | **109** | **58** | **74** | **65** | **62** | **63** |

**Treguesit e Performancës 2016 - 2024**




| | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Incidente ATM | 5 | 7 | 7 | 6 | 0 | 6 | 8 | 8 | 4 |
| Navigimi | 6 | 14 | 9 | 11 | 19 | 8 | 4 | 9 | 1 |
| Survejimi | 1 | 2 | 2 | 2 | 4 | 19 | 0 | 7 | 2 |
| Komunikimi | 20 | 1 | 5 | 18 | 7 | 32 | 24 | 20 | 9 |
| Funksionit ndihmës i informimit | 16 | 24 | 35 | 21 | 13 | 17 | 49 | 32 | 48 |
| Procesimi I të dhënave | 10 | 7 | 5 | 9 | 9 | 20 | 51 | 83 | 20 |
| Të tjera | 5 | 7 | 2 | 4 | 6 | 7 | 6 | 0 | 5 |
| Totali | 63 | 62 | 65 | 71 | 58 | 109 | 142 | 159 | 89 |

## 13.2. ARSYESHMËRIA PËR RRITJEN E NDODHIVE TË RAPORTUARA

Nga tabela e caqeve dhe treguesve kyç të performancës së sigurisë për vitin 2023 (aneksi 01 i këtijë raporti), vërehet se në kategorinë C ka rritje në numrin total të raportimeve në krahasim me vitet paraprake apo i kanë tejkaluar caqet e planifikuara. Në kategorinë D të raportimeve në krahasim me vitin paraprak gjithashtu vërehet rritje në krahasim me vitin e kaluar.

Në fushën e **funksionit të navigimit**, ka rënie nga viti paraprak dhe nuk është tejkaluar caku i performansës së përcaktuar. Ndodhia në këtë fushë ka të bëjë me DME të DVOR.

Në fushën e **funksionit të survejimit**, ka rënie në krahasim me vitet paraprake dhe nuk është tejkaluar caku i performansës së përcaktuar.

Në fushën e **funksionit të komunikimit**, ka rënie nga viti paraprak dhe nuk është tejkaluar caku i performansës së përcaktuar. Ndodhitë në këtë fushë kryesisht kanë qenë dështimet në linja direkte të cilat nuk varen nga ASHNA dhe në disa raste interferencat ne frekuenca të ndryshme.

Në fushën e **funksionit ndihmës të informimit**, ka rritje në krahasim me vitet paraprake dhe është tejkaluar caku i performansës së përcaktuar. Ndodhitë kryesisht kanë të bëjnë me sistemet e parashikimit të cilat kanë pësuar rënie edhe për shkak të ndërprerjeve në rrjetin e internetit. Pas disa intervenimeve, në tremujorin e fundit ka rënie të dukshme të dështimeve në këtë fushë.

Në fushën e **funksionit të procesimit të të dhënave**, ka ka rënie nga viti paraprak dhe nuk është tejkaluar caku i performansës së përcaktuar. Në këtë fushë fushë gjendja vazhdon të jetë jo e mire, sistemi ATM është i vjetër (i instaluar në vitin 2004) dhe ka vështirësi në procesim të të dhënave. Intervenimet e bëra kanë rezultuar të suksesshme, gjë që vërehet në numrin e ndodhive të raportuara.
ASHNA është në proces të prokurimit të një sistemi të ri ATM dhe nëse gjithqka shkon sipas planifikimeve, brenda 2 viteve sistemi i ri do të instalohet.

Në fushën e **Incidenteve me ndikim të Menaxhimit të trafikut ajror (ATM)** numri I ndodhive në krahasim me vitin e kaluar është më i ulët, dhe nuk është tejkaluar caku i performansës së përcaktuar.

Është e rëndësishme të theksohet se ngritja e vetëdijesimit të personelit për raportime, e mbështetur nga angazhimi i menaxhmentit në fuqizimin e politikës “No Blame” dhe promovimin e kulturës “Just Culture”, ka kontribuar ndjeshëm në shtimin e raportimeve. Ky përmirësim shërben për identifikimin dhe adresimin e boshllëqeve të mundshme, si dhe për forcimin e kapaciteteve, me qëllim rritjen e përgjithshme të nivelit të sigurisë.

# 14. SISTEMI I MENAXHIMIT TË CILËSISË

Divizioni për cilësi dhe përputhshmëri ka bërë kontrollin e dokumenteve në aspektin e cilësisë përgjatë tërë vitit si dhe është përfshirë në Ekipin ISO në përgaditjen e ASHNA për certifikim me ISO 9001:2015.

Zhvillimi i Manualit të Cilësisë – Gjatë periudhës raportuese është zhvilluar Manuali i Cilësisë në formatin e standardit ISO 9001:2015.

Përbërja e materialit është e orientuar në formatin e standardit dhe duke u përshtatur me klauzolat e standardit. Formati i ri i Manualit është bazë për implementimin e standardit, për krijimin dhe adaptimin e dokumenteve të njësive tjera në ASHNA si dhe udhërrëfyes i rëndësishëm për auditimin e brendshëm në aspketin parapërgaditor për certifikim me ISO 9001:2015.

Auditimi i brendshëm për ISO 9001:2015 – Auditor të certifikuar për auditim të brendshëm për ISO 9001:2015 kan zhvilluar auditimin dhe si rezultat janë bërë 23 gjetje, 11 prej të cilave janë minore dhe 12 madhore.

Është shpërndarë "Plani i veprimit të menaxhmentit" dhe aktivitetet janë përfunduar pjesërisht.

Në këtë proces pritet vlerësimi i auditorëve të brendshëm për përmbushjen e aktiviteteve në planin e veprimit nga njësitë.

Auditimi i jashtëm dhe çertifikimi me ISO 9001:2015 – Auditimi i jashtë nënkupton angazhmin e një kompanie të autorizuar për çertifikimin e ASHNA me ISO 9001:2015.

Pasi që ky proces do të duhej të bëhej me procedurë të prokurimit, është dorëzuar deklarata e nevojave dhe specifikat në DPRK. Sipas informatave nga DPRK tenderimi i parë ka dështuar sepse nuk ka pasur konkurrues të përgjegjshëm ndërsa ritenderimi është në proces.

Krijimi i data bazës në "SMD" – Gjatë periudhës së raportimit, është krijuar data baza dhe është duke u popalluar me dokumente që janë aprovuar dhe janë në funksion.

| Aktiviteti | Objektivat | Mënyra e zbatimit të planit të punës / Komente | Planifikimi i aktiviteteve sipas muajve | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Jan | Shk | Mar | Pri | Maj | Qer | Kor | Gus | Sht | Tet | Nën | Dhj |
| Rishikimi dhe Komunikimi i Politikës së Cilësisë së SHNA | Rishikimi i Politikës së Cilësisë së ASHNA | Gjatë këtij viti jnuk ka pasur ndryshime të Politikës së Cilësisë | | | | | | | | | | | | |
| | Komunikimi i Politikës së Cilësisë së ASHNA-s | Gjatë këtij viti Politika e Cilësisë ka vazhduar të komunikohet përmes publikimit në sistemin SMD. | | | | | | | | | | | | |
| Planifikimi i Auditimeve të Cilësisë | Përgaditja e dokumentacionit për kryerje të Auditimeve të Cilësisë | Ka përfunduar planifikimi I auditeve në këtë periudhë raportuese, ndërsa auditimet janë zhvilluar sipas planit të punës.<br>Ka qene e planifikuarf qe vetem nje audit I jashtem te realizohet per certifikim me ISO standard | | | | | | | | | | | | |
| Realizimi I Auditimeve të Cilësisë për kontrollim të nënshtrimit ndaj kërkesave të MMC | Auditimi i Cilësisë për kontrollim të nënshtrimit ndaj kërkesave të Manualit për Menaxhimin e Cilësisë në Departamentet e ASHNA-s | Auditimet janë zhvilluar sipas planit të punës.<br>Ka qene e planifikuarf qe vetem nje audit I jashtem te realizohet per certifikim me ISO standard | | | | | | | | | | | | |
| Identifikimi dhe trajtimi i rasteve të mos-nënshtrimit ndaj kërkesave të Manualit për Menaxhimin e Cilësisë | Përcjellja e nënshtrimit ndaj vërejtjeve (mos-nënshtrimeve) të identifikuara gjatë Auditimeve | Ky aktivitet mbetet të përfundohet në vijim pas realizimitt të Auditimeve dhe përgaditjes per certifikim me ISO standard. | | | | | | | | | | | | |
| Raportimi ndaj Drejtorit | Raportimi i rregullt dhe periodic përmes Raporteve dhe takimeve ndaj Drejtorit për të gjitha cështjet relevante në fushën e Cilësisë | DCSS ka raportuar ndaj Drejtorit në baza të rregullta mbi aspektet e cilësisë. | | | | | | | | | | | | |

## 14.1. KONSULTIMI ME SHFYTËZUESIT E SHËRBIMEVE DHE MATJA E KËNAQSHMËRISË

Duke u bazuar në Nenin 16, Paragrafi 1.12 i Ligjit Nr. 04/L 250 për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, si të Rregullores Nr. 7/2012 të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës mbi Kushtet për Ofrimin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, më 08 dhjetor 2023, është zhvilluar takimi i rregullt vjetor konsultativ me përfaqësuesit e Turkish Airlines, Austrian Airlines, Swiss, Edelweiss dhe Eurokoha.

Ky takim zhvillohet në funksion të ngritjes së cilësisë së shërbimeve tona, duke ndarë me shfrytëzuesit e shërbimeve informacione për planet zhvillimore të ASHNA-s dhe për adresimin e çdo çështjeje me interes.

Po ashtu, në mbështetje të nenit 16, përkatësisht pikës 1.8, 1.12 dhe 1.13 të Ligjit për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA), kemi zhvilluar një anketim për matjen e Kënaqëshmërisë së Konsumatorit me Shërbimet e ASHNA-së për vitin 2024. Nga ky anketim rezulton se shfrytëzuesit e shërbimeve janë shumë të kënaqur me shërbimet e ASHNA-së.



# 15. PERFORMANCA FINANCIARE

## 15.1. DEKLARATA

Pasqyrat financiare të cilat janë të bashkangjitura, përfshirë shënimet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të vitit 2017 "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme", i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007 dhe janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Kjo deklaratë jepet në lidhje me prezantimin e Pasqyrave Financiare të organizatës buxhetore për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024 dhe është pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Ne besojmë dhe konfirmojmë, që:

- Nuk ka pasur parregullsi lidhur me udhëheqësin apo me punëtorët, e cila ka mundur të ketë efekt material në pasqyrat financiare;
- Informatat e dhëna dhe të prezantuara në pasqyrat financiare lidhur me burimin e fondeve dhe shpenzimin e tyre të lidhura me Buxhetin e konsoliduar të Kosovës janë të plota dhe të sakta;
- Informatat në lidhje me grumbullimin e të hyrave janë të sakta;
- Nuk ka tjera llogari bankare të Buxhetit të Republikës së Kosovës përveç llogarive bankare të specifikuara në pasqyrat financiare dhe ky specifikim është i plotë dhe i saktë si në datën 31 dhjetor 2024;
- Nuk ka pasur shkelje të kërkesave të autoriteteve rregullatore të cilat kanë mundur të kenë efekt material në pasqyrat financiare;
- Nuk ka ndonjë ankesë (ligjore) në proces e cila mund të ketë efekt material në pasqyrat financiare
- Të gjitha detyrimet, si ato aktuale ashtu edhe kontingjente, dhe të gjitha garancitë që u kemi dhënë palëve të treta janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur në mënyrën e duhur;
- Të gjitha huat e pranuara janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur, sipas legjislacionit në fuqi
- Nuk ka pasur asnjë transaksion pas përfundimit të periudhës i cili do të kërkonte korrigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare apo në shënimet e tyre.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare që janë të bashkangjitura paraqesin një prezantim të vërtetë dhe të paanshëm të financave dhe transaksioneve financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024.

Në vitin 2024, ASHNA ka pasur ngritje të theksuar të njësive terminale të shërbimit krahasuar me vitin 2023 në lartë prej 15.1 %.

## 15.2. KOSTOJA E NJËSISË

Llogaritja e kosotos së njësisë terminale të navigacionit (TNC) për vitin 2024 ka rezultuar nga zbatimi I metodologjisë së përcaktuar në Rregulloren nr. 03/2016 të AAC-së mbi përcaktimin e skemës së përbashkët të tarifave për shërbimet e navigacionit ajror. Bazuar në këtë metodologji, TNC llogaritet për vitin “n” në bazë të kostove dhe trafikut të vlerësuar për atë vit.

Kostoja e njësisë në vitin 2024 ka qenë 380 Euro.

| Muaji | Realizimi 2024 | Realizimi 2023 | Ndryshimi | Ndryshimi ne % |
|---|---|---|---|---|
| Janar | 1,352.33 | 1,086.24 | 266 | 24.5% |
| Shkurt | 1,081.23 | 807.77 | 273 | 33.9% |
| Mars | 1,207.91 | 978.69 | 229 | 23.4% |
| Prill | 1,249.14 | 1,310.99 | (62) | -4.7% |
| Maj | 1,366.01 | 1,287.87 | 78 | 6.1% |
| Qershor | 1,459.32 | 1,337.25 | 122 | 9.1% |
| Korrik | 1,932.71 | 1,805.34 | 127 | 7.1% |
| Gusht | 1,977.42 | 1,818.33 | 159 | 8.7% |
| Shtator | 1,521.73 | 1,354.46 | 167 | 12.3% |
| Tetor | 1,468.92 | 1,217.25 | 252 | 20.7% |
| Nentor | 1,341.78 | 973.64 | 368 | 37.8% |
| Dhjetor | 1,607.12 | 1,284.77 | 322 | 25.1% |
| **Total** | **17,566** | **15,263** | **2,303** | **15.1%** |

## 15.3. PLANIFIKIMI DHE REALIZIMI I TË HYRAVE

Realizimi i të hyrave për shërbime terminale dhe hungaro control për vitin 2024 është **6,485,463.36** apo 0.5% më pak se planifikimi për vitin 2024.

| Nr | Muaji | Planifikimi 2024 | Realizimi 2024 | Ndryshimi | Ndryshimi ne % |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Janar | 369,982.55 | 369,982.55 | 0.00 | 0.0% |
| 2 | Shkurt | 488,209.37 | 538,135.37 | 49,926.00 | 10.2% |
| 3 | Mars | 569,215.55 | 568,330.12 | -885.43 | -0.2% |
| 4 | Prill | 495,622.48 | 390,336.57 | -105,285.91 | -21.2% |
| 5 | Maj | 584,489.64 | 487,974.27 | -96,515.37 | -16.5% |
| 6 | Qershor | 606,924.59 | 479,865.23 | -127,059.36 | -20.9% |
| 7 | Korrik | 741,298.17 | 493,130.45 | -248,167.72 | -33.5% |
| 8 | Gusht | 733,032.66 | 539,229.57 | -193,803.09 | -26.4% |
| 9 | Shtator | 596,297.51 | 747,652.26 | 151,354.75 | 25.4% |
| 10 | Tetor | 462,868.56 | 713,845.39 | 250,976.83 | 54.2% |
| 11 | Nentor | 385,408.92 | 561,810.44 | 176,401.52 | 45.8% |
| 12 | Dhjetor | 481,525.00 | 595,171.14 | 113,646.14 | 23.6% |
| | **Totali** | **€ 6,514,875.00** | **6,485,463.36** | **-29,411.64** | **-0.5%** |

**Të hyrat e përgjithshme të ASHNA-së**

| | |
|---|---|
| Të hyrat nga Shërbimet terminale | 6,168,005 |
| Të hyrat nga Hungaro Control | 317,459 |
| Të hyrat nga kthimet e vitit 2023 | 40,834 |
| **Total i të hyrave** | **6,526,298** |

Përvec të hyrave nga shërbimet dhe të hyrat nga HungaroControl, kemi të hyra tjera që kanë rezultuar nga pagesa e paradhënies për kontratën "Pjesë rezervë për sisteme radarike", me ç'rast është ndërprerë kontrata dhe si rezultat i kësaj operatori ka kthyer mjetet e paradhënies në vlerë 38,767.72 euro.

Gjithashtu kemi një kthim të mjeteve nga pagesa e një trajnimi në vlerë **2,066.65,** i cili është paguar në vitin 2023, ku nuk është mbajtur trajnimi dhe si rezultat janë kthyer mjetet në Janar të vitit 2024.

## 15.4. PASQYRA E PRANIMEVE DHE PAGESAVE NË PARA TË GATSHME

**Pasqyra e pranimeve dhe pagesave të parave të gatshme për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror**
**Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor**

| | Shënim | 2024<br>Llogaria e vetme e Thesarit<br>BKK<br>'000 | 2023<br>Llogaria e vetme e Thesarit<br>BKK<br>'000 | 2022<br>Llogaria e vetme e Thesarit<br>BKK<br>'000 |
|---|---|---|---|---|
| **BURIMET E FONDEVE -PRANIMET** | | | | |
| Granti qeveritar | | 1,425,424 | 1,740.96 | 1,453.00 |
| Të hyrat vetanake | | | | |
| Të hyrat e dedikuara | | 5,663,694 | 4,812.20 | 4,068.89 |
| Grantet e përcaktuara të donatorëve | | | | |
| Financimet nga huamarrja | | | | |
| Klauzola e investimeve | | | | |
| Fondi zhvillimor në mirëbesim | | | | |
| Pranimet tjera | | | | |
| **Gjithsej** | | **7,089,118** | **6,553.16** | **5,521.89** |
| **SHFRYTEZIMI I FONDEVE - PAGESAT** | | | | |
| Operacionet | | | | |
| Paga dhe shtesa | 2 | 3,140,436 | 3,237.13 | 2,911.55 |
| Mallra dhe shërbime | 3 | 1,282,206 | 1,020.17 | 1,179 |
| Shpenzime komunale | 4 | 101,620 | 104.39 | 92.62 |
| | | 4,524,261 | 4,361.70 | 4,182.89 |
| Transferet | | | | |
| Transfere dhe subvencione | 5 | | | |
| Shpenzime kapitale | | | | |
| Prona, ndërtesa dhe pajisje | 6 | 2,564,856 | 2,191.46 | 1,339.00 |
| Pagesa tjera | 7 | | | |
| **Gjithsej** | | **7,089,118** | **6,553.15** | **5,521.89** |

## 15.5. RAPORTI I EKZEKUTIMIT TE BUXHETIT

| | | 2024 | | | | 2023 | 2022 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Realizimi | Buxheti final | Buxheti fillestar | Ndryshimi | Realizimi | Realizimi |
| | | A | B | C | D=B-A | E | F |
| | Shënime | € '000 | € '000 | € '000 | € '000 | € '000 | € '000 |
| **HYRJA E PARASË SË GATSHME** | | | | | | | |
| Të hyrat tatimore | 8 | | | | - | | |
| Të hyrat jo tatimore | 9 | 7 | 6 | 6 | (1) | 77 | |
| Të hyrat e dedikuara | 10 | 6,519 | 7,272 | 7,272 | 753 | 5,958 | 5,888 |
| Grantet e përcaktuara të donatorëve | 11 | | | | - | | |
| Tjera | 12 | | | | - | | |
| **Gjithsej Pranimet** | | **6,526** | **7,278** | **7,278** | **752** | **6,035** | **5,888** |
| **DALJA E PARASË SË GATSHME** | | | | | | | |
| Paga dhe shtesa | 2 | 3,140 | 3,208 | 3,208 | 68 | 3,237 | 2,912 |
| Mallra dhe shërbime | 3 | 1,282 | 2,016 | 2,016 | 734 | 1,020 | 1,179 |
| Shpenzime komunale | 4 | 102 | 162 | 162 | 61 | 104 | 93 |
| Transfere dhe subvencione | 5 | | | | - | | |
| Shpenzime kapitale | 6 | 2,565 | 3,313 | 3,933 | 748 | 2,191 | 1,339 |
| Rezerva | | | | | - | | |
| Tjerat | 7 | | | | - | | |
| **Gjithsej pagesat** | | **7,089** | **8,699** | **9,319** | **1,610** | **6,553** | **5,522** |

Me qëllim të ngritjes së efikasitetit në ekzekutimin e buxhetit dhe përmbylljes së vitit fiskal 2024, bazuar në nenin 15 paragrafin 5 të ligjit nr 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, lidhur me transferimin e shumave të ndara buxhetore, ASHNA ka deklaruar si kursime 620,000 euro në kategorinë e shpenzimeve kapitale përkatësisht në projektin “Sistemi i ri ATM”, prandaj buxheti final në këtë kategori është 3,312,550 euro.

Tek të hyrat jo tatimore kemi një të hyre që ka rezultuar nga pagesa e paradhënies për kontratën “Pjesë rezervë për sisteme radarike” me ç’rast është ndërprerë kontrata dhe si rezultat i kësaj, operatori ka kthyer mjetet e paradhënies në vlerë 38,767.72 euro. Meqenëse pagesat janë bërë nga dy fondet (23 dhe 10) gjithashtu edhe kthimet janë bërë ne fondin 10 vlera 7,025.72 ndërsa në fondin 23 vlera 31,742.

## 15.6. SHPALOSJA E NDARJEVE FILLESTARE DHE FINALE TË BUXHETIT

| Kategoria e ndarjes | Buxheti Fillestar (Ligji i Buxhetit) € '000 | Ndryshimi I € '000 | Ndryshimi II € '000 | Ndryshimi III € '000 | Ndryshimi IV € '000 | Të hyrat vetanake € '000 | Grantet e percaktuara te donetoreve € '000 | Burime tjera te financimit € '000 | Buxheti përfundimtar SIMFK € '000 | Ndryshimet e buxhetit fillestar € '000 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Ndryshimet e autorizuara nga LMFPP | | | | | | | | |
| **Hyrjet** | | | | | | | | | | |
| Të hyrat tatimore | | | | | | | | | - | |
| Të hyrat jo tatimore | 6 | | | | | | | | 6 | |
| Të hyrat e dedikuara | 7,272 | | | | | | | | 7,272 | 0 |
| Grantet e përcaktuara të donatorëve | | | | | | | | | - | |
| Huamarrjet | | | | | | | | | - | |
| Tjera | | | | | | | | | - | |
| **Gjithsej** | **7,278** | **-** | **-** | **-** | | **-** | **-** | **-** | **7,278** | **0** |
| **Daljet** | | | | | | | | | | |
| Paga dhe shtesa | 3,208 | | | | | | | | 3,208 | 0 |
| Mallra dhe shërbime | 2,016 | | | | | | | | 2,016 | 0 |
| Shpenzime komunale | 162 | | | | | | | | 162 | 0 |
| Transfere dhe subvencione | | | | | | | | | - | |
| Shpenzime kapitale | 3,933 | (620) | | | | | | | 3,313 | -0.157658517 |
| Rezerva | | | | | | | | | | |
| Kthimi i huamarrjeve | | | | | | | | | - | |
| Tjerat | | | | | | | | | - | |
| **Gjithsej** | **9,319** | **(620)** | **0** | **0** | | **0** | **0** | **0** | **8,699** | **-6.7%** |

Tek kategoria e shpenzimeve kapitale kemi një ndryshim tek buxheti i aprovuar dhe buxheti final për shkak që ASHNA ka deklaruar si kursime 620,000 euro në kategorinë e shpenzimeve kapitale përkatësisht në projektin “Sistemi i ri ATM” me qëllim të ngritjes së efikasitetit në ekzekutimin e buxhetit dhe përmbylljes së vitit fiskal 2024, bazuar në nenin 15 paragrafin 5 të ligjit nr 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, lidhur e transferin e shumave të ndara buxhetore.

## 15.7. PAGAT DHE SHTESA

| | 2024 | | | | | | | | | | 2023 | 2022 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Gjithsej | | | | | | | | Buxheti | Ndryshimi | | |
| | Pagesat | FH | KI | FZHM | GQ | THV | THD | GPD | Final | Buxheti - Pagesat | | |
| Përshkrimi | € '000 | € '000 | € '000 | € '000 | € '000 | € '000 | € '000 | € '000 | € '000 | € '000 | € '000 | € '000 |
| Paga Neto | - | | | | | | - | | | | | |
| Pagat neto përmes listës së pagave | 1,619 | | | | | | 1,619 | | | | 2,622 | 2,421 |
| Pagesa per sindikatë | 11 | | | | | | 11 | | | | 3 | 8 |
| Tatimi në të ardhurat personale | 225 | | | | | | 225 | | | | 229 | 205 |
| Kontributi pensional - punëtori | 150 | | | | | | 150 | | | | 150 | 139 |
| Shtesa për vëllimin e punës | 5 | | | | | | 5 | | | | | |
| Kujdestaria, puna gjatë natës dhe puna jashtë orarit të punës | 422 | | | | | | 422 | | | | | |
| Funksionet shtesë | 2 | | | | | | 2 | | | | | |
| Shtesat tranzitore | 313 | | | | | | 313 | | | | | |
| Kontributi pensional-punëdhënësi | 150 | | | | | | 150 | | | | 150 | 139 |
| Shtesa për kushte të tregut të punës | 139 | | | | | | 139 | | | | | |
| Përvoja e punës | 105 | | | | | | 105 | | | | | |
| Vendimet e gjykatave | 0 | | | | | | 0 | | | | 82 | |
| **Paga dhe shtesa** | **3,140** | **-** | **-** | **-** | **-** | **-** | **3,140** | **-** | **3,208** | **68** | **3,237** | **2,912** |

## 15.8. MALLRA DHE SHËRBIME

| | 2024 | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Përshkrimi | Gjithsej Pagesat € '000 | FH € '000 | KI € '000 | PZH M € '000 | GQ € '000 | THV € '000 | THD € '000 | GPD € '000 | Buxheti Final € '000 | Ndryshimi Buxheti - Pagesat € '000 | 2023 € '000 | 2022 € '000 |
| Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit | 59.10 | | | | | | 59.10 | | 70 | 10.90 | 15.84 | 49.83 |
| Meditjet për udhëtime zyrtre jashtë vendit | 160.81 | | | | | | 160.81 | | 150 | (10.81) | 51.02 | 94.78 |
| Akomodimi udhëtime zyrtre jashtë vendit | 197.74 | | | | | | 197.74 | | 140 | (57.74) | 59.98 | 94.80 |
| Shpenzime tjera udhëtime zyrtre jashtë vendit | 22.79 | | | | | | 22.79 | | 10 | (12.79) | 4.73 | 17.68 |
| Interneti | - | | | | | | - | | 2 | 1.50 | | |
| Telefonia mobile | 10.56 | | | | | | 10.56 | | 12 | 1.44 | 10.89 | 11.21 |
| Shpenzimet postare | 0.07 | | | | | | 0.07 | | 2 | 1.93 | 0.28 | 0.55 |
| Shpenzimet për kabllot optike | 8.51 | | | | | | 8.51 | | 20 | 11.49 | 10.00 | 9.92 |
| Shërbimet e arsimit trajnimit | 215.46 | | | | | | 215.46 | | 640 | 424.54 | 152.20 | 326.14 |
| Shërbimet e përfaqësimit avokaturë | 2.15 | | | | | | 2.15 | | 30 | 27.85 | | |
| Shërbime të ndryshme shëndetsore | 47.40 | | | | | | 47.40 | | 95 | 47.60 | 55.10 | 30.80 |
| Shërbime këshilldhënësë dhe profesionale | - | | | | | | - | | 30 | 30.00 | | |
| Shërbime të vecanta | | | | | | | | | 15 | 15.00 | | |
| Sherbimet e shtypjes/printimit | 10.40 | | | | | | 10.40 | | 4 | (6.90) | 3.48 | 4 |
| Sherbimet kontraktuese tjera | 61.84 | | | | | | 61.84 | | 40 | (21.51) | 72.30 | 68.49 |
| Sherbimet teknike | 9.42 | | | | | | 9.42 | | 33 | 23.08 | 28.74 | 21 |
| Paisje (me pak se 1000 euro) | 7.77 | | | | | | 7.77 | | 8 | 0.23 | 8.17 | 8 |
| Sherbimet per antaresim | 29.97 | | | | | | 29.97 | | 13 | (17.04) | 12.93 | 13 |
| Furnizime pastrimi | 11.26 | | | | | | 11.26 | | 10 | (1.26) | 5.52 | |
| Harduer për teknologji informative (më pak se 1000 euro) | | | | | | | | | - | - | | 6 |
| Furnizime për zyre | 3.89 | | | | | | 3.89 | | 9 | 5.11 | 3.33 | 7 |
| Furnizim me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare) | 9.71 | | | | | | 9.71 | | 15 | 5.29 | 8.58 | 8 |
| Furnizim me veshmbathje | 7.91 | | | | | | 7.91 | | 8 | 0.09 | 0.96 | 7 |
| Derivate per gjenerator | | | | | | | | | 6 | 6.00 | 2.32 | 1 |
| Karburante per vetura | 16.53 | | | | | | 16.53 | | 25 | 8.47 | 17 | 21 |
| Regjistrimi i Automjeteve | 1.66 | | | | | | 1.66 | | 3 | 1.34 | 1.55 | 1 |
| Sigurimi i Automjeteve | 4.97 | | | | | | 4.97 | | 5 | 0.03 | 4.62 | 5 |
| Taksat Komunale | 0.24 | | | | | | 0.24 | | 1 | 0.76 | 0.18 | 0.2 |
| Mirembajtja e Teknologjise Informative | 33.60 | | | | | | 33.60 | | 13 | (20.60) | 7.74 | 34 |
| Mirëmbajtja dhe Riparimi i Automjeteve | 9.02 | | | | | | 9.02 | | 14 | 4.48 | 11.09 | 9 |
| Sigurimi i ndertesave dhe tjera | 135.63 | | | | | | 135.63 | | 165 | 29.37 | 137.54 | 150 |
| Mirëmbajtja e mobiljeve dhe pajisjeve | 157.24 | | | | | | 157.24 | | 386 | 228.76 | 168.98 | 134 |
| Mirëmbajtja e ndërtesave | 27.32 | | | | | | 27.32 | | 15 | (12.32) | 10.93 | 21 |
| Mirëmbajtje rutinore | 6.27 | | | | | | 6.27 | | 12 | 5.23 | 8.79 | 8 |
| Shpenzimet per Informim publik | 0.69 | | | | | | 0.69 | | 2 | 1.31 | 2.08 | 0 |
| Kompensim i përfaqesimit brenda vendit | 11.40 | | | | | | 11.40 | | 6 | (5.40) | 6.82 | 5 |
| Kompensim i përfaqesimit jasht vendit | 0.07 | | | | | | 0.07 | | | (0.07) | 1.40 | |
| Vaji | 0.01 | | | | | | 0.01 | | 7 | 6.49 | 2.42 | 3 |
| Vendime Gjyqesore | 0.80 | | | | | | 0.80 | | | (0.80) | 132.88 | 8 |
| Avance per para te imet | | | | | | | | | 3 | 3.00 | | |
| | **1,282** | **-** | **-** | **-** | **-** | **-** | **1,282** | **-** | **2,016** | **734** | **1,020** | **1,179** |

## 15.9. SHPENZIME KOMUNALE

| Përshkrimi | 2024 Gjithsej Pagesat € '000 | FH € '000 | KI € '000 | FZHM € '000 | GQ € '000 | THV € '000 | THD € '000 | GPD € '000 | Buxheti Final € '000 | Ndryshimi Buxheti - Pagesat € '000 | 2023 € '000 | 2022 € '000 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Energjia elektrike | 74 | | | | | | 74 | | 120 | 46 | 79 | 71 |
| Shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit | 1 | | | | | | 1 | | 2 | 1 | 1 | 1 |
| Mbeturinat | 1 | | | | | | 1 | | 3 | 2 | 1 | 0 |
| Ngrohja qendrore | 11 | | | | | | 11 | | 25 | 14 | 11 | 11 |
| Telefonia fikse | 15 | | | | | | 15 | | 12.37 | (2) | 13 | 10 |
| Pagesat -vendimet gjyqësore | - | | | | | | - | | | | | |
| Pagesat sipas 39.2 të LMFPP-së | - | | | | | | - | | | | | |
| **Shpenzime komunale** | **102** | **-** | **-** | **-** | **-** | **-** | **102** | **-** | **162** | **61** | **104** | **93** |

## 15.10.SHPENZIMET KAPITALE

| | 2024 | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Gjithsej | | | | | | | | Buxheti | Ndryshimi | 2023 | 2022 |
| | | | | | | | | | | Buxheti - | | |
| | Pagesat | FH | KI | FZHM | GQ | THV | THD | GPD | Final | Pagesat | | |
| **Përshkrimi** | € '000 | € '000 | € '000 | € '000 | € '000 | € '000 | € '000 | € '000 | € '000 | € '000 | € '000 | € '000 |
| Ndërtesat e banimit | 61.1 | | | | | 61.11 | | | 61 | 0.39 | | |
| Ndërtesat administrative dhe afariste | - | | | | | - | | | | | 5.3 | 136.52 |
| Objektet arsimore | - | | | | | - | | | | | | |
| Objektet shëndetësore | - | | | | | - | | | | | | |
| Objektet kulturore | - | | | | | - | | | | | | |
| Objektet sportive | - | | | | | - | | | | | | |
| Monumentet dhe komplekset memoriale | - | | | | | - | | | | | | |
| Rrethojat | - | | | | | - | | | | | | |
| Depot | - | | | | | - | | | | | | |
| Garazhet | - | | | | | - | | | | | 2.7 | |
| Fushat sportive | - | | | | | - | | | | | | |
| Autorrugët | - | | | | | - | | | | | | |
| Rrugët regjionale | - | | | | | - | | | | | | |
| Rrugët lokale | - | | | | | - | | | | | 10.9 | |
| Trotuarët | - | | | | | - | | | | | | |
| Rrjetet e kanalizimit | - | | | | | - | | | | | | |
| Rrjetet e ujësjellësit | - | | | | | - | | | | | | |
| Pajisjet e gjenerimit të energjisë elektrike dhe ndr | - | | | | | - | | | | | | |
| Pajisjet e tjera të teknologjisë informative dhe te k | - | | | | | - | | | | | 79.0 | 88.71 |
| Pajisjet mjekësore | - | | | | | - | | | | | | |
| Mobile | 66.1 | | | | | 66.15 | | | 66 | | 5.8 | |
| Vendime te Gjykates | | | | | | | | | | | 793.1 | 67.08 |
| Paisje Tjera | 2,378.0 | | | | | 2,377.96 | | | 3,005 | | 1,294.7 | 445.40 |
| Paisje Hardwer | | | | | | | | | | | | 601.28 |
| Vetura zyrtare | 59.6 | | | | | 59.64 | | | 180 | | | |
| Shto kode sipas nevojës | - | | | | | - | | | | | | |
| **Shpenzime Kapitale** | **2,565** | **-** | **-** | **-** | **-** | **2,565** | **-** | **-** | **3,313** | **748** | **2,191** | **1,339** |

Ndryshimi mes vlerës së aprovuar dhe realizimit të buxhetit kapital është për shkak të mos realizimit të disa nga projektet e planifikuara si:

- ✓ Energjia e ripërtritëshme në vlerë 360,000 Euro, është ritenderuar në vitin 2024, ku aktualisht është në OSHP dhe ende nuk kemi një vendim nga OSHP për këtë projekt;
- ✓ Pajisje për linjat e dedikuara në vlerë 50,000 euro, ky projekt aktualisht është në OSHP;
- ✓ Furnizimi me kvm Sëitch në vlere 35,000 euro, ka dështuar në mungesë të operatorëve të përgjegjshëm;
- ✓ Upgrade i Radarit në Golesh në vlerë 1,200,000 euro, në bazë të kontratës të nënshkruar me OE, vlera prej 180,000 euro, mbetet për realizim për vitin 2025, me që financimi është planifikuar nga fondi 23.

## 15.11.TË ARKËTUESHMET

| Kodi ekonomik | Përshkrimi | 2024 | 2023 | 2022 |
|---|---|---|---|---|
| | 50401 Shitja e Sherbimeve | 484,369.91 | 388,158.07 | 426,366.56 |
| **Gjithsej** | | **484,369.91** | **388,158.07** | **426,366.56** |

| Data e lëshimit te fatures | Numri i faturës | Kodi ekonomik | Afati i pagesës | Furnitori | Përshkrimi | 2024 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 05.12.2024 | 0024/2024 | 50401 | 30 ditë | LIMAK | Approachfee Nëntor -2024 | 484,369.91 |
| **Gjithsej** | | | | | | **484,369.91** |

# 16. RAPORT PËR GJENDJEN/ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT (ZKA)

“Raporti i auditimit për ASHNA për vitin 2024”, përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i ASHNA për vitin 2024. Ky raport pritet të jetë publik deri në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2025.

| Nr | Rekomandimi | Veprimi i ndërmarrë | Afati i zbatimit | Statusi aktual i rekomandimit | Vlerësimi i rrezikut |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Çështja B1 - Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve - Drejtori i ASHNA-së duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që të planifikohen shpenzimet drejtë apo të bëhet ridestinim i mjeteve dhe që realizimi i pagesave të bëhet në kategorinë adekuate për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV, në përputhje me planin kontabël. | ASHNA do të ndërmarr veprimet e nevojshme me kohë ashtu që planifikimi i shpenzimeve të bëhet në përputhje me natyrën e projekteve dhe kategorinë ekonomike adekuate gjegjësisht kodin ekonomik përkatës sipas planit kontabël në fuqi. | Tetor – Nëntor 2024 | I përmbushur | Prioritet i lartë |
| 2 | Çështja A1 - Nënvlerësim i regjistrit të pasurive - Drejtori i ASHNA-së duhet të sigurojë se janë vendosur kontrollet e duhura të cilat mundësojnë regjistër të plotë dhe të saktë të pasurisë, në mënyrë që raportimi i tyre në PFV të jetë i drejtë dhe i vërtetë. | Ky rekomandim tani më është adresuar. Janë shtuar kontrollet e brendshme për raportet e pasurisë të pranuara nga zyrtari i pasurisë se a janë gjeneruar saktë në SIMFK. | Qershor 2024 | I përmbushur | Prioritet i lartë |
| 3 | Çështja C1 - Mangësi në menaxhimin e sistemit e-pasuria - Drejtori duhet të marrë të gjitha veprimet e nevojshme për të vënë në përdorim sistemin e-pasuria duke i evidentuar dhe mirëmbajtur pasuritë nën 1,000€ dhe stoqet, dhe i njëjti të jetë bazë për raportimin e pasurisë në PFV. | Ky rekomandim tani më është adresuar, sistemi e-pasuria është funksionalizuar dhe janë evidentuar të gjitha pasuritë nën 1,000€ dhe stoqet. | Qershor 2024 | I përmbushur | Prioritet i lartë |
| 4 | Çështja A2 - Mos përmbushje e planit të NJAB-së - Drejtori i ASHNA-së duhet të krijojë kushtet për realizimin e plotë të planit të aprovuar të auditimit, përmes së cilit ofrohet mbështetja dhe siguria e menaxhmentit në lidhje me efektivitetin e kontrolleve kyçe. | Do të ndërmerren veprimet e nevojshme në mënyrë që te implementohet plani i aprovuar i auditimit. | Dhjetor 2024 | I përmbushur | Prioritet i lartë |

# 17. MENAXHIMI I RREZIQEVE TË ORGANIZATËS

KANS (ASHNA) përmes Manualit për Menaxhimin e Riskut dhe shtojcave të tij, gjegjësisht kushteve të menaxhimit të riskut që derivojnë nga LIGJI NR. 03/L-048 PËR MENAXHIMIN E FINANCAVE PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSITË dhe RREGULLORE MF-NR. 01/2019 PËR MENAXHIMIN FINANCIAR DHE KONTROLLIN, gjatë vitit 2024 ka identifikuar dhe menaxhuar rreziqet administrativo-financiare që mund të cënojnë objektivat e KANS (ASHNA).

Menaxhimi i riskut bashkërëndon procesin e përgjithshëm të menaxhimit dhe strukturën e organizative në mënyrë që të dyja së bashku të sigurojnë një kornizë të kombinuar për pritjet dhe përgjegjësitë organizative dhe individuale.

Menaxhimi i riskut konfirmon angazhimin strategjik të KANS (ASHNA) për ndërtimin e një kulture të menaxhimit të rrezikut në të cilën rreziqet dhe mundësitë janë identifikuar dhe menaxhuar në mënyrë efektive.

Tabela në vijim është azhurnuar gjatë vitit 2024 dhe derivon nga Manuali për Menaxhimin e Riskut, i përmendur si Shtojca C REGJISTRI I RREZIQEVE.

Dokumenti përmbledh (përmes tabelës) ciklin e menaxhimit të riskut, duke filluar nga identifikimi, vlerësimi dhe masat korigjuese.

| OBJEKTIVI I CËNUAR | Risk ID | RREZIKU | NDIKIMI | M | N | R | MASAT E PROPOZUARA | M | N | R | PËRGJEGJËS PËR ZBATIM |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Kodi I Rrezikut | Identifikimi i rrezikut | Çfarë mund të shkaktojë pasojat e mundeshme | Mundësia | Ndikimi | Niveli I riskut | Për reduktimin e riskut | Mundësia | Ndikimi | Niveli I riskut | Hierarkia e Punës |
| Normalizimi e hapësirës së ulët ajrore (Mali i Zi) | 01 RJ | Faktorët politik | Pamundësia e hapjes së rrugëve ajrore me Malin e Zi | 3 | 2 | 6 | Komunikimi I vazhdueshëm me palë interesi si Qeveria, NATO dhe Autoritetet e Malit të Zi për shërbime të navigacionit ajror; | 1 | 2 | 2 | Drejtori ASHNA |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | Pjesëmarrja në takime të BANM; | | | | |
| Përmirësimi dhe modernizimi i sistemeve të navigacionit ajror | 02 RB | Mos-funksionalizim i ATM në TWR | Vonesat në realizimin e projektit; Pamundësia e përdorimit të sistemit ATM në TWR | 3 | 3 | 9 | Vlerësimi i sigurisë në fazën përkatëse të implementitmit të projektit: Kërkesa për miratim të fazes së projektit në kohë te AACK; | 2 | 3 | 6 | Menaxheri i Projektit DCSS |
| | 03 RJ | Pamundësia e ndërveprimit me Eurocontrol (ARTAS) | Pamundësia e integrimit në sisteme rajonale dhe globale; Kosto shtesë; Modifikimi i kontratës aktuale për ATM | 3 | 3 | 9 | Adresimi në Qeveri, NATO, ICETRA, Eurocontrol; Blerja e pajisjes së re (tracker) Zhvillimi i procedurave përkatëse | 3 | 2 | 6 | Qeveria Drejtori ASHNA |
| | 04 RB | Mos-planifikimi dinamik i procesit të prokurimit për AMHS | Vonesat në realizimin e projektit; Pamundësia e realizimit të buxhetit | 3 | 3 | 9 | Inicimi dhe zhvillimi i procesit të prokurimit të bëhet në tremujorin e parë (2025). | 2 | 3 | 6 | Menaxheri DTEK Menaxheri DPRK |
| Ngritja e kapaciteteve njerëzore | 05 RB | Mos-rekrutimi i student kontrollorëve të trafikut ajror | Vështirësi në mbulim të pozitave operuese; Vonesa në përgatitjet për dhënie të shërbimeve në Hapësirën e lartë ajrore | 3 | 3 | 9 | Inicimi dhe zhvillimi i procesit të rekrutimit të bëhet në tremujorin e parë (2025). Sigurimi i ofertave në kohë nga instucionet trajnuese | 2 | 2 | 4 | DBNJ DZHT |
| Shfrytëzimi i burimeve natyrore të energjisë | 06 RB | Mos-zhvillimi në kohë i procedurave të prokurimit | Pamundësia e instalimit dhe shfrytëzimit të paneleve solare | 4 | 2 | 8 | Inicimi dhe zhvillimi i procesit të prokurimit të bëhet në tremujorin e parë; Vlerësimet e ofertave të zhvillohen nga zyrtarë kompetent. | 2 | 2 | 4 | DADM DPRK |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Ofrimi i shërbimeve të navigacionit ajror | 07 RJ | Mos - antarësimi në institucionet relavante të aviacionit civil | Pamundësia e integrimit në sisteme rajonale dhe globale;<br>Mungesa e informacionit për kërkesat e së ardhmes; | 4 | 3 | 12 | Adresimi te Qeveria dhe te AACK;<br>Informimi i palëve të jashtme, si NATO, Eurocontrol, KFOR dhe kërkesa për përkrahje në këtë çështje;<br>Procedura të veçanta të punës<br>Instalimi dhe përdorimi i rrjeteve dhe sistemeve alternative;<br>Pjesëmarrje aktive në konferenca dhe ngjarje tjera. | 4 | 3 | 12 | Qeveria<br>AACK<br>ASHNA |
| | 08 RJ | Forcat madhore | Pamundësia e ofrimit të shërbimeve të navigacionit ajror | 3 | 5 | 15 | Plani kontigjent;<br>Procedura operacionale;<br>Trajnimi i personelit. | 3 | 3 | 9 | Drejtori i ASHNA;<br>Menaxherët |
| | 09 RJ | Tërheqja e mjeteve financiare nga buxheti i ASHNA-së për kompensimin e obligimeve për eksproprimin e tokave të ANPs | Pamundësia e realizimit të buxhetit sipas planifikimit; | 4 | 3 | 12 | Zgjidhja e kontestit administrative mes ASHNA dhe MMPHI | 1 | 3 | 3 | Qeveria<br>ASHNA |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Menaxhimi i financave publike | 10 RB | Devijimi nga zbatimi i rregullave të menaxhimit financiar, kontrollin kontabilitetin dhe përgatitjes së raportimit financiar | Menaxhimin jo-efektiv i fondeve që mund të rezultoj në krijimin e mungesës së fondeve për aktivetet përkatëse. | 3 | 3 | 9 | Ngritja e kapaciteteve profesioanle në këtë fushë;<br>Ofrimi i këshillave nga Auditori i Brendshem;<br>Shtimi i kontrolleve të brendshme. | 2 | 2 | 4 | Zv. Drejtori Adminstrativ-Financiar;<br>Auditori i Brendshëm;<br>ZYDR (Zyrtari Çertifikues) |
| Menaxhimi i Burimeve Njerëzore | 11 RB | Largimi i numrit të personelit deficitar me aftësi, njohuri dhe eksperiencë relevante | Vështirësi në mbulim të pozitave operuese;<br>Mbingarkesë e personelit aktual;<br>Shtim i kompenzimit te punës jashtë orarit | 3 | 3 | 9 | Rritje e pagave;<br>Përmirësimi i kushteve të punës; | 1 | 3 | 3 | Drejtori ASHNA<br>Menaxheri DBNJ |
| Ofrimi i Shërbimeve të Informacionit Aeronautik (AIS) | 12 RJ | Mos-lidhja e marrëveshjes për procesim të mesazheve aeronatuike me Islandën | Pamundësia e ofrimit të shërbimeve të navigacionit ajror | 3 | 5 | 15 | Koordinim proaktiv me Islandën;<br>Definim i saktë i termave të marrëveshjes. | 1 | 5 | 5 | Drejtori ASHNA |
| Siguria e personelit dhe mjedisit të punës | 13 RB | Zjarri në lo-kacionet e sitemeve esenciale të ASHNA | Rrezikimi i personelit;<br>Demtimi I sistemeve/paisjeve;<br>Pamundësia e ofrimit te shërbimeve | 3 | 4 | 12 | Krijimi i barrierave fizike kunder zjarrit;<br>Sigurimi dhe mirëmbajtja e pajiseve kunder zjarrit;<br>Trajnimet rifreskuese per masat preventive kunder zjarrit dhe mbrojtese.<br>Lidhja e marrëveshjes me LKIA për intervenim ne rast zjarri. | 2 | 4 | 8 | Drejtori ASHNA;<br>DBNJ;<br>DZHT |
| Menaxhimi i projekteve | 14 RB | Mos - Identifikimi dhe mos – adresimi | Pamundësia e prokurimit të pajisjeve/shërbimeve; | 3 | 4 | 12 | Komunikimi me nivelet përkatëse në njësi organizative gjatë hartimit | 2 | 2 | 4 | Menaxherët e Departamenteve |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | në kohë i nevojave për shërbime, pajisje etj... | Vështirësi në kryerjen e aktiviteteve përkatëse; Pamundësia e përfshirjes në planifikimet buxhetore dhe të prokurimit | | | | të planeve të punës, planifikimeve buxhetore, planifikimeve të prokurimit dhe planeve tjera. | | | | |
| | 15 RB | Specifikat teknike jo adekuate | Dështimet/vonesat në proces të prokurimit<br>Mos realizimi i buxhetit<br>Prokurimi i produkitit/shërbimit jo adekuat | 3 | 3 | 9 | Të draftohet një procedurë, ku përcaktohen kriteret për hartimin e specifikave teknike | 2 | 2 | 4 | ZYDR |
| | 16 RB | Mungesa e kompetencës për vlerësimin e ofertave | Dështimet/vonesat në proces të prokurimit<br>Mos realizimi i buxhetit | 3 | 3 | 9 | Komisionet e vlerësimit të caktohen në përbërje të personave kompetent | 2 | 2 | 4 | Drejtori ASHNA<br>Njësia kërkuese |
| | 17 RB | Menaxhimi jo adekuat i kontratave | Vonesa në projekt<br>Mos realizimi i buxhetit | 3 | 3 | 9 | Të azhurnohet PR-ZYDR-06 me kriteret për emërim të menaxherit të kontratës (kush duhet të jetë projekt menaxher) | 2 | 2 | 4 | ZYDR |
| Ofrimi i shërbimeve të navigacionit ajror | 18 RJ | Mos aprovimi I projekt ligjit të ASHNA-së | Vonesat në normalizimin e hapersires ajrore;<br>Largimi i numrit të personelit deficitar;<br>Pamundesia e realizimi I projekteve esenciale dhe zhvillimore; | 4 | 3 | 12 | Kominikim i vazhdueshëm me palët e interesit në Qeveri, Kuvend dhe AACK | 3 | 3 | 9 | Kuvendi<br>Qeveria<br>Drejtori i ASHNA-së |

# 18. BURIMET NJERËZORE

Burimet njerëzore në janë vlera dhe pasuria kryesore e KANS (ASHNA), të cilëve ju kushtohet vëmendje e veçantë në të gjitha nivelet dhe proceset.

Duke pasur parasysh specifikat e profileve të fuksioneve në KANS (ASHNA), vëmendje e theksuar i kushtohet rekrutimit, zhvillimit, trajnimit dhe mirëqenies së personelit të saj, në mënyrë që të sigurohet performance maksimale në përmbushjen e detyrave të tyre.

## 18.1. PERSONELI I KANS

ASHNA ka gjithsej 158 të punësuar, të specializuar në fusha të ndryshme, të cilët janë të ndarë në personelin operativ dhe personelin administrative.

Struktura e personelit sipas gjinisë




| Burra | Gra |
|---|---|
| 81% | 19% |

---

Struktura e personelit sipas moshës




| 18-30 | 31-40 | 41-50 | 51-60 | 60-65 |
|---|---|---|---|---|
| 10% | 24% | 45% | 19% | 2% |

Struktura e personelit sipas etnisë




| Shqiptar | Serb | Turk | Boshnjak | RAE | Goran |
|---|---|---|---|---|---|
| 156 | 0 | 2 | 1 | 0 | 0 |

# 19. TRAJNIMET

KANS ka zhvilluar aktivitete të shumta në ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve njerëzore dhe profesionale, në përputhje me planin vjetor të trajnimeve dhe nevojat specifike të identifikuara gjatë vitit 2024.

Janë realizuar trajnime në rajon si dhe trajnime vendore, kryesisht me prezencë fizike. Ndër aktivitetet kryesore në fushën e trajnimeve vecojmë:

- Realizimi i trajnimeve të specializuara për stafin operativ dhe administrativ;
- Organizimi i trajnimeve rifreskuese për kontrollorët e trafikut ajror;
- Bashkëpunimi i suksesshëm me qendra trajnuese ndërkombëtare si Entry Point North, ENAV, Gate Aviation dhe DFS;
- Pjesëmarrja e stafit të DZHT-së në Komisione të ndryshme te themeluara me vendim te drejtorit te ASHNA-së;
- Nënshkrimi i kontratës për “Sigurim Shëndetësor për personelin e ASHNA-së”;
- Nënshkrimi i kontratës për testimin “FEAST” për student kontrollorët e trafikut ajror, që pritet të organizohet gjatë vitit të ardhshëm;
- Trajnimi për Ekspert për siguri dhe shëndet në punë;
- Testimi për gjuhë angleze për 9 kontrollorë të trafikut ajror, për vazhdim të miratimit të gjuhës.



Ofrimi i shërbimeve të sigurta dhe cilësore të navigacionit ajror kërkon përkushtim maksimal në të gjitha fushat e veprimit. Një nga shtyllat kryesore për arritjen e këtij qëllimi është garantimi i përgatitjes profesionale dhe mbajtjes së vazhdueshme të nivelit të lartë të kompetencës së personelit të angazhuar. Duke qenë se standardet dhe kërkesat në këtë fushë janë jashtëzakonisht të larta, edukimi, trajnimi dhe ngritja profesionale e stafit duhet të trajtohen si prioritet i vazhdueshëm.

Për të përmbushur standardet ndërkombëtare dhe për të siguruar që shërbimet e navigimit ajror të jenë në përputhje me praktikat më të mira globale, është thelbësore që zyrtarët të pajisen me njohuri të përditësuara dhe aftësi praktike të avancuara. Kjo kërkon organizimin e programeve të trajnimit të rregullt dhe kurseve të specializuara, si dhe bashkëpunimin me institucione ndërkombëtare të fushës për shkëmbim përvojash dhe rritje të kompetencës.

Për më tepër, procesi i ngritjes profesionale duhet të mbështetet nga një qasje sistematike që fokusohet në identifikimin e nevojave të trajnimit, përgatitjen e materialeve të përshtatura për zhvillim profesional dhe krijimin e një mjedisi që inkurajon edukim të vazhdueshëm. Vetëm përmes një angazhimi të tillë strategjik dhe të qëndrueshëm mund të sigurohet cilësia dhe siguria e lartë që kërkohet në sektorin e navigacionit ajror, duke ndikuar pozitivisht në performancën e përgjithshme.

# 20. PRIRORITETET PËR 2025

Në Planin e Performancës për vitin 2025, planet e biznesit dhe në të gjitha planifikimet tjera përkatëse për vitin 2025, KANS (ASHNA) ka përcaktuar dhe vendosur objektivat kryesore, përkatësisht prioritetet e saj.

- IMPLEMENTIMI I LIGJIT Të KANS
  Aktet nënligjore

- NORMALIZIMI I HAPËSIRËS AJRORE
  Hapësira e ulët - hapja e pikave dhe rrugëve ajrore me Malin e Zi;
  Hapësira e lartë – përgatitja e personelit

- Ngritja e kapaciteteve njerëzore
  Rekrutimi dhe shkollimi i student kontrollorëve të trafikut ajror

- Përmirësimi dhe modernizimi i sistemeve të navigacionit ajror
  Implemetimi i Sistemit ATM
  Instalimi i Sistemit AMHS

- SHFRYTËZIMI I BURIMEVE NATYRORE TË ENERGJISË
  Prokurimi, instalimi dhe funsksionalizimi i panleve solare

- VENDOSJA E STANDARDIT ISO (9001/2015)
  Çertifikimi